



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT STUDIMOR

MBI VENDIMMARRJEN E
INSTITUCIONEVE TË
RIVLERËSIMIT KALIMTAR
(VETTINGU)

Janar - Dhjetor 2019

—



RAPORT STUDIMOR

MBI VENDIMMARRJEN E INSTITUCIONEVE TË RIVLERËSIMIT KALIMTAR (VETTINGU)

Referuar vendimeve të KPK-së dhe KPA-së të dhëna gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019

Publikuar në dt. 21 Tetor 2020

Ky raport u përgatit nga Komitetit Shqiptar i Helsinkit (KShH) në kuadër të nismës “Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut - III”, projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga KShH. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e KShH-së dhe ekspertëve që kanë kontribuar në hartimin e tij dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).



Përgatitën:

1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së
2. Znj. Malvia Dani, Eksperte ligjore

Kontribuuan në realizimin e raportit (sipas rendit alfabetik):

1. Znj. Iva Plaushku, Koordinatore Projekti, KShH
2. Znj. Mirela Bogdani, Pedagoge, Fakulteti i Drejtësisë (UT)

Konsulencë Ligjore:

1. Dr. Rainer Deville, Ekspert ligjor ndërkombëtar
2. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671 / Mob: 0694075732

Web site: www.ahc.org.al

HYRJE

Procesi i vettingut, ose rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve është një nga shtyllat më të rëndësishme të reformës në sistemin e drejtësisë, e cila ka sjellë rezultate të konsiderueshme në drejtim të pastrimit të sistemit gjyqësor, nga gjyqtarë apo prokurorë me probleme në një apo disa kriterë si pasuria, figura dhe aftësitë profesionale.

Me frymën e një kritike dhe oponente profesionale, të paanshme dhe konstruktive, KShH ka monitoruar hapat kryesorë të zbatimit të procesit të vettingut në vendin tonë, duke i shërbyer si informimit të qytetarëve dhe medias për rezultatet e këtij procesi, por gjithashtu edhe nevojës për përmirësimin dhe konsolidimin e veprimtarisë së institucioneve të vettingut.

Objekt i këtij raporti studimor është një kampion prej 90 vendimesh të dhëna nga Institucionet e rivlerësimit kalimtar, prej të cilave janë studiuar 63 vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe 27 vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (KPA), për periudhën Janar – Dhjetor 2019. Në vendimet e KPK përfshihen gjithashtu 8 vendime të dhëna në vitin 2018. Ky raport studimor është i dyti i këtij lloji, pasi KShH ka publikuar një raport të ngjashëm për vendimmarrjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit për periudhën 9 mujore që i përket vitit të kaluar (Shkurt – Tetor 2018) dhe që mund të aksesohet në këtë link:

<http://www.ahc.org.al/ep-content/uploads/2019/03/Raport-Studimor-Për-Vendimmarrjen-E-Institucioneve-Të-Rivlerësimit-Kalimtar-Të-Gjyqtarëve-Dhe-Prokurorëve-Vetting.pdf>.

Nëpërmjet këtij raporti të dytë studimor, KShH analizon disa nga aspektet, gjetjet dhe problematikat e identifikuara mbi vendimmarrjen e institucioneve të vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Metodologjia e përdorur për kryerjen e studimit mbështetet në analizën e të dhënave në aspektin cilësor por edhe sasior të vendimeve që janë kampioni i këtij raporti studimor. Në përputhje me misionin e tij, KShH është ndalur më shumë në mënyrën se si organet e vettingut kanë zbatuar parimet e procesit të rregullt si dhe nëse vendimmarrja e tyre ka patur ose jo konsistencë apo njëtrajtshmëri përgjatë këtij harku kohor. Qasja e ekspertëve që kanë punuar këtë raport studimor ka qenë e pavarur, e paanshme, bazuar në përvojën profesionale të deritanshme të KShH-së, në monitorimin e këtij procesi si dhe në bindjen e tyre të brendshme.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në periudhën objekt i këtij studimi, Janar – Dhjetor 2019, rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka dhënë në total 129 vendime, prej të cilave 52 vendime për konfirmim në detyrë, 48 vendime për shkarkimin nga detyra, 12 vendime për ndërprerje të procesit¹, 16 vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar si dhe një vendim për pezullimin e subjektit nga detyra. Në të njëjtën periudhë, rezulton se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përfunduar shqyrtimin gjyqësor të 34 ankimeve. Pas shqyrtimit gjyqësor, KPA, në 26 raste është vendosur lënia në fuqi e vendimit të KPK-së, ndërkohë që në 7 raste është ndryshuar vendimi i KPK-së, nga konfirmim në detyrë në shkarkimin nga detyra të subjektit dhe për një subjekt është ndryshuar vendimin e Komisionit, por pa ndryshuar masën e shkarkimit nga detyra.

Gjatë periudhës objekt studimi, vettingu ka vijuar të ketë një impakt pozitiv në radhët e publikut, sa i takon përmbushjes së objektivave kryesore të tij, për identifikimin e subjekteve të cilët kalojnë ose jo me sukses tre kriteret themelore të tij; pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale.

KPK, në mënyrë të dukshme vijon ti kushtojë vëmendje parësore, vlerësimit të kriterit pasuror të subjekteve, në raport me dy kriteret e tjera, figurën dhe aftësitë profesionale. Ndonëse procesi i hetimit ka filluar për të tre kriteret e rivlerësimit, konstatohet se ka pasur raste kur Komisioni e ka gjetur të mjaftueshme të deklarojë të përfunduar fazën hetimore bazuar në një ose dy kriteret. Në rastet kur vendimi është bazuar në një kriter, subjektet i ka penalizuar pasuria. Ndërkohë, kur vendimmarrja është bazuar në dy kriteret, mbizotërues është kriteri i pasurisë, i kombinuar me pastërtinë e figurës ose *aftësitë* profesionale. Vetëm ndaj një subjekti (A. Ç),² KPK ka vendosur shkarkimin e tij bazuar në tre kriteret.

Praktika e KPA-së vlerësohet të ketë sjellë risi në kuadër të interpretimit të burimit të ligjshëm të ardhurave, pamjaftueshmërisë së të ardhurave dhe pasaktësisë së plotësisë të deklaratës vetting. Vlen të theksohet se Kolegji ka përpunuar dy metodologji orientuese me indikatorë dhe nënindikatorë për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale (në çështjen ndaj subjektit G. M) dhe një metodologji për vlerësimin e kriterit pasuror (në çështjen ndaj subjekti N.K). Metodologjitë e mësipërme janë orientuese dhe ndihmëse për trupat gjyqësore të Kolegjit dhe Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit.

Vërehet se trupa gjyqësore e KPK për disa subjekte ka vendosur për masën e shkarkimit nga detyra bazuar në një ose dy kriteret, por duke përdorur si referencë ligjore nenin 61 paragrafi 5 të

¹ Aneks i Kushtetutës; Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve; Neni G Dorëheqja 1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose 6 prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

² Vendimi Nr. 95, datë 08.01.2019.

ligjit nr.84/2016. Kjo dispozitë parashikon se subjekti shkarkohet në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.³ Në vlerësimin tonë, por referuar gjithashtu doktrinës⁴, shkarkimi për shkak të cënimit të besimit të publikut nuk mund të bëhet duke u bazuar në një nga kriteret, për arsye se sipas pikës 5 kërkohet një vlerësim tërësor i të tre kriterëve; pra cënim në një nivel të besueshëm në të tre elementët, për të vlerësuar pamundësinë e qëndrimit në detyrë.

Një rol të rëndësishëm në procesin e vettingut vijojnë të kenë denoncimet e publikut për subjekte të rivlerësimit, të cilët qytetarët i kanë konsideruar të padenjë për të vazhduar detyrën si gjyqtarë apo prokurorë. Bashkëpunimi i organeve të vettingut me qytetarët gjen reflektim edhe në vendimet që janë studiuar në kuadër të këtij raporti, ku në disa raste, denoncimet e tyre janë reflektuar në pjesën arsyetuese të vendimeve. Në disa raste, faktet dhe provat e denoncuar nga publiku kanë ndikuar në vendimin që kanë marrë organet e vettingut.

Nga studimi i kampionit të vendimeve që janë dhënë gjatë kësaj periudhe është evidentuar fakti se për raste të ngjashme, nga ana e KPK-së ka patur mungesë të një linje të konsoliduar në vendimmarrje, gjë që ka çuar në vlerësime të ndryshme të subjekteve që janë në rrethana të ngjashme. Kjo mungesë konsistence është vërejtur në drejtim të:

- a) interpretimit dhe analizës së kryer nga trupat gjykuese të KPK-së, lidhur me mangësitë apo parregullsitë e konstatuara në deklaratat periodike vjetore të pasurisë (DPV) që subjektet kanë paraqitur pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI). Në disa raste, këto mangësi apo parregullsi janë konsideruar gabime të paqëllimshme, ndërkohë për raste të ngjashme trupat gjykuese të KPK-së kanë vendosur për shkarkim të subjektit⁵.
- b) interpretimit lidhur me pranimin ose jo të provave të depozituara për justifikimin e burimit të ligjshëm të pasurisë. Në disa raste, trupat gjykuese të KPK-së kanë çmuar se provat e sjella nga subjekti nuk janë të rregullta, duke konkluduar për mosjustifikim të burimit të krijimit të të ardhurave. Kjo praktikë është e diskutueshme sa i takon pajtueshmërisë me kompetencat e përcaktuara nga aneksi kushtetues dhe ligji përkatës nr.84/2016.⁶

Çështje e diskutueshme është përkufizimi i termit burim i ligjshëm i të ardhurave dhe kush do të cilësohen të tilla. Referuar vendimmarrjes së studiuar, të KPK-së dhe KPA-së, rezulton se burim i ligjshëm do të konsiderohet çdo e ardhur nga e cila janë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore sipas ligjit mbi të ardhurat. Mgjth, jo gjithmonë pagesa e tatimit mbi të ardhurat ligjëron një të ardhur. Në rastin e të ardhurave të siguruara në mënyrë të jashtëligjshme si pastrimi i

³ Ligji Nr.84/2016 Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

⁴ Komentari: “Mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016), faqe 540-541.

⁵ Vendimi për subjektin E.T, A.B, D.P

⁶ Kodi i Procedurës Penale në nenin 281/3 parashikon: “Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën vepër penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori”.

parave, ose të ardhura të krijuara nga veprimtari kriminale, për të cilat janë paguar tatimet përkatëse, burimi është i jashtëligjshëm. Këto pasuri nuk përmbushin kriterin kushtetues të burimit të ligjshmërisë së krijimit të tyre. Koncepti i ligjshmërisë jo gjithmonë nënkupton pagesën e tatimit, ndonëse për të ardhurat nga paga, apo shpërblimet e tjera, pagesa e tatimit nënkupton një lehtësi në gjurmimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, por jo gjithmonë e ligjërojnë atë. Gjithashtu edhe doktrina në mendimet e saj argumenton se ligjshmërinë e një pasurie apo të ardhurave nuk e bën domosdoshmërisht pagesa e tatimeve.⁷

Një element i diskutueshëm në vendimet e studiuara është llogaritja e shpenzimeve mesatare për jetesë, që i referohet llogaritjes që INSTAT parashikon. Indeksi mesatar i shpenzimeve i përcaktuar nga INSTAT nuk pasqyron shpenzimet reale dhe efektive të subjekteve, pasi metodologjia e përlllogaritjes së këtij zëri ka në konsideratë shumatoren e pagave minimale me ato maksimale. Në këtë drejtim, mund të nevojitet një metodologji e unifikuar që përcakton indikatorët matës për realizimin e analizës financiare të shpenzimeve.

Në kampionët e vendimeve të organeve të vettingut që janë marrë për studim, edhe pse ka patur disa vendime për shkarkim, për shkak të kriterit të pasurisë, nuk vërejmë ndonjë rast kur subjektet të kenë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe rrjedhimisht të jenë shkarkuar sipas kësaj dispozite. Pavarësisht nga përmbajtja e nenit 61, pika 1 e ligjit nr.84/2016, që parashikon “kufirin e justifikimit të pasurisë”; në po këtë nen, pikat 3 dhe 5 krijojnë hapësirë për interpretim.

Studimi i vendimeve të organeve të vettingut reflekton në raport me gjermën e ligjit një paanshmëri të trupave gjyquese të KPK-së dhe KPA-së. Mgjith, mungesa e konsistencës së vendimmarrjes së trupave gjyquese të KPK-së, në disa raste sporadike të vendimeve të studiuara, mund të krijojë premisa për paragjykimë sa i takon çështjes së paanshmërisë, në mënyrë të veçantë kur përbërja e trupave gjyquese është e njëjtë apo pothuajse e njëjtë, por vendimmarrja e tyre për çështje të ngjashme është e ndryshme.

Duke ju referuar në mënyrë strikte vetëm përmbajtjes së një vendimi gjyqësor (për të dyja instancat e vettingut) nuk mund të arrihet në konkluzione shteruese për sa i takon respektimit të barazisë së armëve juridike të subjektit. Nga studimi i vendimeve të organeve të vettingut, vihet re se ka patur raste kur subjektet e rivlerësimit i janë drejtuar KPK-së dhe KPA-së për marrjen e provave, të cilat janë refuzuar nga trupat gjyquese. Kjo është ndeshur më së shumti kur subjektet kanë kërkuar provën për marrjen e dëshmisë dhe kryerjen e ekspertimit (Shih vendimet, A. Gj⁸, D.S⁹).

⁷ Komentari Mbi Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë, Instituti për Studime Publike dhe Ligjore,

⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.100 datë 14.01.2019

⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.114 datë 11.03.2019

Referuar vendimeve të deritanishme të organeve të vettingut rezulton se zbatimi i parimit të proporcionalitetit prej tyre nuk reflekton një linjë të konsoliduar, në mënyrë të veçantë për subjektet që kanë rrethana faktike apo procedurale të ngjashme. Megjithatë, duhet të kemi në konsideratë se faktet dhe rrethanat e çështjeve konkrete, pavarësisht ngjashmërive, nuk janë dhe as nuk mund të jenë identike. Ndaj ky konstatim referuar vendimeve të studiuara nuk mund të jetë i plotë. Zbatimi i drejtë i parimit të proporcionalitetit nga organet e vettingut kërkon një qartësim dhe unifikim të praktikës së KPK-së dhe të KPA-së se çfarë do të konsiderohet fshehje e pasurisë dhe kur pasaktësitë në plotësimin e deklaratave apo mosdeklarimi nuk përbën fshehje.

Është pozitiv fakti se në vendimet e studiuara të KPK-së, përveç shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës të lëshuar nga ILDKPI si organ ndihmës, KPK ka kryer një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës për disa subjekte, duke arritur në përfundime të tjera nga ato të ILDKPKI-së, për mënyrën e përfitimit të pasurisë së tyre.

Organet e rivlerësimit, në analizën për kriterin e aftësive profesionale të subjekteve janë mbështetur në relacionet e vlerësimit të hartuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (për gjyqtarët) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (për prokurorët), si dhe relacionet e vlerësimit të paraqitura gjatë periudhës tranzitore të funksionimit të KLD-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Megjithatë, është e paqartë, përse ka lindur nevoja për të dubluar relacionet e organeve tranzitore për aftësitë profesionale të subjekteve me relacionet e marra nga të dy Këshillat.

Në këndvështrimin krahasues, vendimet e KPA-së paraqesin një standart më të mirë dhe më të konsoliduar sa i takon strukturës së vendimit por gjithashtu edhe cilësisë së tij. Si në vendimet e KPK-së dhe në ato të KPA-së pasqyrohet në mënyrë të detajuar mendimi i gjyqtarëve të pakicës ose mendimi paralel. KPK në tre raste ka marrë vendim me shumicë votash, kurse në 45 raste vendimmarrja është me votë unanime. Ndërkoë që KPA, për 10 vendime të shqyrtuara, rezulton se në tre prej tyre, anëtarët e trupës kanë shfaqur mendim ndryshe nga shumica dhe në një rast kemi një mendim paralel.

1. Respektimi i së drejtës për proces të rregullt në vendimmarrjen e organeve të vettingut

1.1 Parimi i paanshmërisë

Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) parashikon një sërë garancish që trupi gjyqësor duhet të ketë (parasysht), me qëllim që të respektohet e drejta për proces të rregullt. Element i rëndësishëm është pavarësia e trupës gjyqësore e cila është shtjelluar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut (GJEDNJ).¹⁰

Në vendimet e marra në shqyrtim rezulton i pasqyruar përbërja e trupës gjyqësore dhe deklarimi i anëtarëve që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Në vendimet e KPK-së, është vërejtur një rast kur relatori i çështjes ka paraqitur kërkesë për dorëheqje pasi ka qënë në kushtet e konfliktit të interesit¹¹. Për vendimet e KPA-së, vërehet se asnjë nga subjektet e rivlerësimit nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtim të anëtarit/anëtarëve të trupit gjyqësor, gjithashtu nuk pasqyrohet në asnjë nga vendimet qënia e anëtarëve në kushtet e konfliktit të interesit. Por pavarësisht nga kjo, Kolegji ka marrë në shqyrtim ankimet e subjekteve, ku ndër të tjera, janë pretenduar shkelje procedurale për sa i takon shqyrtimit të kërkesave të tyre për paanshmëri të trupit gjyqësor të rivlerësimit kalimtar në shkallë të parë, pra në KPK. Konkretisht, për subjektin A.L, KPA vëren se kërkesa e subjektit për përjashtimin e një anëtari të trupit gjyqësor në KPK, nuk u shqyrtua rregullisht sipas ligjit, nga një trupë tjetër gjyqësore e KPK-së. Kjo rrethanë e la paanshinë e trupit gjyqësor të hapur ndaj dyshimit, pasi vendimin lidhur me faktin nëse dyshimi është apo jo i justifikueshëm, nuk mund ta marrë i njëjti komisioner kundër të cilit ngrihen pretendimet.¹²

Në rastin e subjektit Dh.L të rivlerësuar nga KPK vërehet se “Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjyqësor i Komisionit, pasi dëgjoi subjektin i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere F.Sh, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit”¹³. Përfshirja e termit rekomandim në këtë vendimmarrje është e diskutueshme pasi mund të perceptohet si një influencim i vullnetit të anëtares tek dy anëtarët e tjerë të trupës gjyqësore të KPK. Ligji parashikon se komisionerët udhëhiqen nga parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë.

Çështja e paanshmërisë mund të shtrohet për diskutim, në mënyrë të veçantë kur përbërja e trupave gjyqësore është e njëjtë apo pothuajse e njëjtë, por vendimmarrja e tyre për çështje të

¹⁰ European Court of Human Rights, Guide on Article 6 of the European Convention on Human Right, faqe 46.

¹¹ Vendimi i KPK-së, nr.108, dt 15.02.2019, për subjektin H.D

¹² Kolegji i Posaçëm i Apelit vendimi Nr.1 date-31.01.2019, faqe 8.

¹³ Ibid, faqe 31

ngjashme është e ndryshme. Konkretisht, në rastin e vendimmarrjes për subjektin E.T, megjithëse nga analiza e gjetjeve dhe provave vërehet se subjekti ka mangësi në plotësimin e deklaratave, ai është konfirmuar në detyrë; ndërkohë që për subjektin F.E ka një vendimmarrje të ndryshme që ka sjellë shkarkimin e tij, për pasaktësi të ngjashme me subjektin E.T (edhe pse 2/3 e anëtarëve të trupit gjykues janë të njëjtë në rivlerësimin kalimtar të këtyre subjekteve).

1.2 Parimi i barazisë së armëve juridike

Element dhe parim i rëndësishëm për cilësimin e një procesi të rregullt, i mishëruar në nenin 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, është gjithashtu edhe barazia e armëve juridike. Parimi i barazisë së armëve lidhet ngushtësisht me mundësinë që i jepet palës për të paraqitur prova ku mbështet pretendimet/kërkesat e saj si dhe me parimin e kontradiktoritetit.

Duke ju referuar në mënyrë strikte vetëm përmbajtjes së një vendimi gjyqësor (për të dyja instancat e vettingut) nuk mund të arrihet në konkluzione të plota për sa i takon respektimit të barazisë së armëve juridike të subjektit. Megjithatë, nga studimi i vendimeve të organeve të vettingut, vihet re se ka patur raste kur subjektet e rivlerësimit i janë drejtuar KPK-së dhe KPA-së për marrjen e provave, të cilat janë refuzuar nga trupat gjykuese. Kjo është ndeshur më së shumti kur subjektet kanë kërkuar provën për marrjen e dëshmisë dhe kryerjen e ekspertimit (Shih vendimet, A. Gj¹⁴, D.S¹⁵).

Ligji nr. 84/2016 në nenin 49, pika 9 të tij parashikon se *“refuzimi i kërkesës për marrjen e provës bëhet me vendim të arsyetuar duke argumentuar shkaqet e refuzimit”*. KShH vëren se, KPK, në pjesën më të madhe të vendimeve për shkarkim shprehet për refuzimin e marrjes së provave të kërkuara nga subjektet, duke specifikuar bazën ligjore ku e mbështet vendimmarrjen, por pa dhënë arsytim mbi refuzimin. Në rastet kur subjekti ka kërkuar marrjen e provës së dëshmisë, Komisioni e ka refuzuar këtë kërkesë, pasi kjo është paraqitur prej tyre në një formë tjetër, përkatësisht me deklaratë noteriale. Ndaj, KPK ka vërejtur se në kuptim të nenit 46 pika 3 të ligjit nr. 84/2016, marrja e provës duket se është e panevojshme, ose fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen (Shih vendimin për subjektin A. Z¹⁶ dhe A. Gj¹⁷). Përjashtimisht, Komisioni, për subjektin e rivlerësimit F.P ka vendosur të thërrasë dëshmitarët, pavarësisht deklaratës së lëshuar prej tyre, me arsytimin se në këtë shkresë referohen një numër veprimesh financiare (arkëtime dhe pagesa), të cilat nuk pasqyrohen në dokumentacionin bashkëlidhur, ndaj u vlerësua e nevojshme thirrja e një seance dëgjimore me përfaqësues të shoqërive huamarrëse në administrim¹⁸. Mgjith, KShH ka patur akses vetëm në vendimet përfundimtare të KPK-së dhe jo në vendimet e ndërmjetme të tij, ndaj nuk përjashtohet

¹⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.100 datë 14.01.2019

¹⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.114 datë 11.03.2019

¹⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 97 datë 10.01.2019

¹⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 100 datë, 14.01.2019

¹⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 136 datë 09.04.2019.

mundësia e argumentimit të refuzimit të kërkesave për marrjen e provës në këto lloj vendimesh. **Pavarësisht nga kjo, kemi mendimin se pasqyrimi i argumentave për refuzimin e marrjes së provave, qoftë edhe në mënyrë të përmbledhur në vendimet përfundimtare do të kontribuonte më mirë në drejtim të transparencës dhe vlerësimit të publikut për garantimin ose jo të procesit të rregullt ndaj subjekteve.**

Në këtë kontekst, i sugjerojmë KPK-së që në një pjesë të posaçme të vendimit përfundimtar të pasqyrojë në formën e një tablele përmbledhëse provat që janë paraqitur nga subjektet, cilat janë pranuar dhe cilat janë refuzuar, duke përshkruar në mënyrë të përmbledhur motivacionin e refuzimit.

2. Vendimmarrja bazuar në një ose disa kritere

Në vendimmarrjen që përkon me periudhën e studimit, në shumicën dërrmuese të vendimeve të shkarkimit, Komisioni ka vendosur bazuar vetëm në një ose dy kritere, ndonëse procesi i hetimit dhe kontrollit është realizuar për të tre kriteret e rivlerësimit.

Në rastin e shkarkimit të subjekteve bazuar në një kriter, kryesisht, mbizotërues është kriteri i pasurisë. Ndërkohë, kur vendimmarrja është bazuar në dy kritere, mbizotërues ka qenë kriteri i pasurisë, i kombinuar me pastërtinë e figurës ose *aftësitë* profesionale. Në këtë periudhë, vetëm ndaj një subjekti (A. Ç),¹⁹ KPK ka vendosur shkarkimin e tij bazuar në tre kriteret. Institucionet e vettingut kanë saktësuar se vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm mbi një kriter nuk përbën gjë të gjykuar (res judicata) për dy kriteret e tjera.²⁰

Praktika e përfundimit të procesit të rivlerësimit bazuar në një kriter mbështetet në jurisprudencën e konsoliduar të Komisionit dhe Kolegjit të Apelimit, të cilët arsyetojnë se vendimmarrja e tyre është në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.²¹

Neni 61/5 i ligjit nr.84/2016 përcakton se subjekti shkarkohet në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.²² Në vlerësimin tonë, zbatimi i kësaj dispozite bazuar në përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm në një kriter është i diskutueshëm. Edhe doktrina ndan mendimin se shkarkimi për shkak të cënimit të besimit të publikut nuk mund të bëhet duke u bazuar në një nga kriteret, për arsye se sipas pikës 5 kërkohet një vlerësim tërësor i të tre kritereve; pra cënim në një nivel të besueshëm në të tre kriteret për të vlerësuar pamundësinë e qëndrimit në detyrë.²³ Për subjektin

¹⁹ Vendimi Nr. 95, datë 08.01.2019.

²⁰ Vendimi Nr. 111 datë 27.02.2019

²¹ Shih vendimin Nr. 34 datë 11.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Vendimin Nr.3 datë 17.07.2018 për çështjen Nr. 4/2018, Regjistër (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

²² Ligji Nr.84/2016 Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

²³ Komentar: “Mbi reformën kushtetuese në systemin e drejtësisë (2016), faqe 540-541.

A.K, Komisioni ka vendosur përfundimin e procesit të rivlerësimit për të tre kriteret dhe në përfundim ka argumentuar shkarkimin e subjektit nga detyra mbështetur në nenin 61/5, ndonëse për kriterin e pastërtisë së figurës dhe aftësive profesionale, rezulton me vlerësim pozitiv.²⁴ Për subjektin A.Gj, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, duke vendosur shkarkimin e tij bazuar në nenin 61/5.²⁵ E njëjta praktikë është ndjekur për subjektin P.Ç, ku është vendosur përfundimi i rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë dhe është vendosur shkarkimi bazuar në nenin 61/3 dhe 61/5 të ligjit nr.84/2016.²⁶

3. Parimi i proporcionalitetit

Ligji nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” sanksionon në nenin 4 se, Komisioni dhe Kolegji udhëhiqen nga parimi i proporcionalitetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve të tyre. Gjithashtu, ky parim theksohet në nenin 54 të ligjit nr.84/2016.

Referuar vendimeve të deritanishme të organeve të vettingut rezulton se zbatimi i parimit të proporcionalitetit prej tyre nuk reflekton një qasje apo linjë të konsoliduar, në mënyrë të veçantë për subjektet që kanë rrethana faktike apo procedurale të ngjashme. Megjithatë, lidhur me këtë konstatim por edhe konstatime të tjera në vijim të këtij raporti, duhet të kemi në konsideratë se faktet dhe rrethanat e çështjeve konkrete, pavarësisht ngjashmërive, nuk janë dhe as nuk mund të jenë identike.

Konkretisht, KPK për subjektin e rivlerësimit D. P, në analizën e përfitimit të kredisë së butë nga subjekti justifikon vendimmarrjen: “...duke konsideruar edhe faktin që në këtë procedurë janë përfshirë edhe aktorë, kontrollues dhe autorizues të ndryshëm, kjo kredi nuk duket se do të gjeneronte një përgjegjësi të drejtpërdrejtë të subjektit të rivlerësimit, dhe gjithsesi ajo nuk mund të përbënte, në vetvete, një shkak të mjaftueshëm për aplikimin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.²⁷ Për rastin e ngjashëm me subjektin e rivlerësimit A.K, KPK ka konkluduar se ky subjekt ka përfituar padrejtësisht nga statusi si i pastrehë, kur ka përfituar kredi të butë për strehim.²⁸

²⁴ Vendimi Nr. 113, datë 08.03.2019.

²⁵ Vendimi Nr. 100 datë 14.01.2019

²⁶ Vendimi Nr. 111 datë 27.02.2019

²⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendim Nr. 112, datë 04.03.2019, faqe 9

²⁸ Shih Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimi Nr. 113 datë 08.03.2019

4. Periudha kur shtrihet procesi i rivlerësimit

Lidhur me periudhën në të cilën duhet të shtrihet procesi i rivlerësimit të pasurive të subjekteve të vetting-ut, KPA sërish ka interpretuar Kushtetutën dhe Ligjin 84/2016, në ndryshim nga qëndrimi i mbajtur nga KPK. Konkretisht, KPA ka konkluduar se, në asnjë dispozitë nuk parashikohen kritere vlerësimi të kushtëzuara me periudha kohore të krijimit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, pasi nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, që janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive për të cilat nuk mund të justifikohet ligjërisht burimi i tyre apo që posedojnë të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj’ (shih Vendimin 19/2019 i KPA, pika 22.16).

Lidhur me faktin se pasuria objekt rivlerësimi i bashkëshortit të subjektit është përfituar përpara lidhjes së martesës, ndaj si e tillë nuk është rrjedhojë e ushtrimit të detyrës si gjyqtar/prokuror (subjekt rivlerësimi) dhe, për pasojë, nuk duhet t’i nënshtrohet kontrollit, KPA ka elaboruar standartin se ‘... cdo pasuri që është deklaruar dhe është në pronësi, posedim apo përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, në momentin e deklarimit, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimit, si dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit’ (shih para. 2&3 i fq. 24, Vendimi 23/2019 i KPA).

5. Kontrolli i pasurisë

Vlerësimi i burimit të krijimit të të ardhurave dhe ligjshmëria e tyre kanë qenë komponentët kryesorë në vendimmarrjen e organeve të vettingut në kontrollin e kriterit të pasurisë, si në rastet kur subjekti është shkarkuar ashtu edhe kur është konfirmuar në detyrë. Në këtë seksion, janë analizuar disa aspekte të rëndësishme të vendimeve të studiuara lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, përkatësisht në këto drejtime kryesore:

5.1 Raportet e organit ndihmës ILDKPKI dhe provat e siguruara nga hetimi administrativ i institucioneve të vettingut

Analiza për disa vendime ndaj subjekteve të rivlerësimit ka evidentuar se KPK, përveç shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës të lëshuar nga ILDKPI si organ ndihmës, ka kryer një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës për disa subjekte, duke arritur në përfundime të tjera nga ato të ILDKPKI-së, për mënyrën e përfitimit të pasurisë së tyre. KPK në këto raste ka analizuar mënyrën e përfitimit të pasurive të paluajtshme, dokumentacionin për origjinën e pronës, është

shprehur gjithashtu për ligjshmërinë dhe vlefshmërinë e këtyre akteve, etj. Kështu, për subjektin A.Gj, KPK vlerëson se ai ka në pronësi të fshehur një apartament në qytetin e Durrësit,²⁹ (shih gjithashtu vendimet e KPK-së për subjektin A. Ç³⁰, dhe A.K³¹). Kjo praktikë e ndjekur nga KPK për të arritur në konkluzione lidhur me ligjshmërinë apo vlefshmërinë e akteve të përfitimit të pasurisë është e diskutueshme. Veçanërisht, në rast se organet e vettingut konstatojnë elementë të veprës penale në lidhje me krijimin dhe përdorimin e këtyre dokumentave, atëherë ato duhet të bëjnë kallëzim në prokurori.³²

Në rastin e subjektit të rivlerësimit L.H është konkluduar se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting”, duke deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhura të krijuara pas datës së lidhjes së kontratës së shitjes.³³ Për këtë subjekt, mospërfshirja e kredisë bankare si burim për krijimin e pasurisë Apartament në vitin 2006 krijon situatën kur subjekti është në kushtet e mos mbulimit me të ardhura të ligjshme të pasurisë së krijuar dhe shpenzimeve të realizuara. Në kushtet kur Komisioni nuk është bindur për burimin e ligjshëm të të ardhurave me anë të kredisë, analiza mund të shtrihej dhe për vitin 2007, vit kur efektivisht është marrë si kredi. Kjo për faktin se duhej të merrej në konsideratë koha e aplikimit për kredinë, rregullat e institucionit dhe koha e aprovimit të saj.

5.2 Raporti i deklaratave periodike të subjekteve pranë ILDKPKI-së me deklaratën vetting

Deklarimet periodike të plotësuar ndër vite përsa i përket pasurisë dhe konfliktit të interesit nga subjektet (gjyqtarët dhe prokurorët), kanë kontribuar në vendimmarrjen e organeve të vettingut, të cilat i kanë dhënë atyre në procesin e rivlerësimit, vlerën e proves. Në raportin studimor të mëparshëm, KShH evidentoi mungesën e konsequencës në vendimmarrjen e trupave të KPK-së,

²⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendimi nr. 100, datë 14.01.2019, faqe 30. Në arsyetim, KPK vlerëson se subjektit i rivlerësimit ka në pronësi të fshehur apartamentin në qytetin e Durrësit. Këtë apartament subjekti i rivlerësimit e ka përdorur në periudha të caktuara të vitit. Referuar dokumentacionit hipotekor ai është i regjistruar në emër të kushëririt të tij, subjektit të lidhur H.Gj.

³⁰ KPK, vendimi i dt. 08.02.2019. KPK arsyeton se mbetet ende e paqartë se si shtëpia + truall e pasqyruar në AMTP me sipërfaqe 500 m², u regjistrua me vendim gjykate me sipërfaqe 600 m², pra, 100 m² më shumë. Për pasurinë e sipërcituar, subjekti në deklaramet e tij ka pohuar se është përfituar me AMTP, por duke qenë tokë truall ajo nuk mund të ndahej dhe në këto kushte babai i tij i është drejtuar Gjykatës për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së shtëpisë dhe truallit.

³¹ KPK, vendimi nr. 113, dt. 08.03.2019. Për këtë subjekt, KPK ka bërë verifikime lidhur me ligjshmërinë e krijimit të apartamenteve të banimit, të cilat janë përfituar me anë të kontratës së shkëmbimit midis firmës ndërtuese dhe subjektit të rivlerësimit. Në analizën e tij, KPK ka verifikuar origjinën e pronës, e cila është blerë nga subjekti i A,K nga pronari i mëparshëm F.A. Pasuria e paluajtshme tokë arë është përfituar nga shitësi F.A nëpërmjet AMTP- së njëra në vitin 1991 dhe një në vitin 1999. Komisioni ka analizuar këto akte dhe ka arritur në përfundim se AMTP të cilat kanë shërbyer si origjinë për krijimin e pasurive të paluajtshme kanë korrigjime, fshirje Komisioni, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë tokë ARË me sipërfaqe 830 m², e cila ka shërbyer si origjinë për përfitimin e tetë pasurive të paluajtshme nga shoqëria “****” sh.p.k

³² Kodi i Procedurës Penale në nenin 281/3 parashikon: “Kur, gjatë një procedimi civil ose administrativ, zbulohet një fakt që përbën veprë penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim te prokurori”.

³³ Vendimi Nr 170 datë 26.06.2019, L.H, faqe 9

në rastet e mospërputhjes së të dhënave midis deklaratave periodike dhe deklaratës vetting. Në disa prej këtyre rasteve, KPK i ka dhënë përparësi deklaratës vetting, por në raste të tjera, janë marrë në konsideratë pasaktësitë dhe shkeljet e evidentuara në deklaratat periodike të subjekteve të paraqitura ndër vite pranë ILDKPKI si organ ndihmës. Kushtetuta, në nenin Ç, pika 4 dhe nenin D të Aneksit të saj, ashtu dhe ligji nr. 84/2016, në nenet 30, 32 dhe 33 të tij, kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit; me qëllim që të identifikohen subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.³⁴

Në rastin e subjektit R.P, KPK ka argumentuar se dokumenti ligjor, në të cilin bazohet hetimi dhe objekti i rivlerësimit kalimtar është pikërisht deklarata Vetting. Deklarimet e mëparshme mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.³⁵ Për mospërputhjet midis deklaratës Vetting dhe deklarimit të vitit 2003, në rastin konkret konstatohet se mungon qëllimi dhe dashja për të bërë deklarim të pasaktë, fshehje, apo deklarim të rremë nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë që vlera e paguar provohet me anë të dokumenteve ligjorë justifikuese.³⁶

Në rastin e subjektit të rivlerësimit E.T, mosdeklarimi i shitjes së mjetit në vitin 2012 në deklaratën periodike dhe Vetting, është argumentuar prej subjektit si pakujdesi njerëzore, dhe gjithashtu është evidentuar prej tij se nuk ka pasur impakt financiar për të vënë pasuri të mëtejshme nga shitja e saj. Ky deklarim i subjektit të rivlerësimit është përputhur me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga KPK, pasi të ardhurat nga shitja e këtij mjeti nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e ndonjë pasurie.³⁷ Për subjektin A.B,³⁸ KPK justifikon mosdeklarimin e gjendjeve Cash në deklaratat periodike për vitin 2003 dhe 2004, duke argumentuar se nuk duhet të merret në konsideratë gjatë procesit përfundimtar të vendimmarrjes. I njëjti standart nuk rezulton të jetë zbatuar për subjektet e rivlerësimit A. K, për të cilin Komisioni, vlerëson se mosdeklarimi i të drejtave reale të pronësisë në deklarimin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, për tetë pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k, është pasaktësi me pasojë deklarim të pamjaftueshem të pasurive nga ana e subjektit, dhe duhet të merret në konsideratë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes.³⁹ Megjithatë, në të dy vendimet e analizuara në këtë paragraf, ka një dallim midis tyre në aspektin e parimit të proporcionalitetit, i cili konsiston në vlerën dhe peshën që ka pasuria e padeklaruar në raport me pasurinë e plotë të subjektit.

³⁴ Vendimi nr. 2 date 04.02.2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

³⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 169, datë 26.06.2019, faqe 4

³⁶ Po aty, faqe 4.

³⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 105 datë 12.02.2012 dhe Vendimin Nr. 116 datë 21.03.2019

³⁸ Shih Vendimin Nr. 135, datë 05.04.2019, faqe 14

³⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 113 datë 08.03.2019

Në rastin e subjektit D.P mungesa e deklaramit të një depozite bankare nga personi i lidhur vlerësohet mangësi në deklaram, por kjo sipas KPK-së, nuk mund të konsiderohet si një fshehje pasi bëhet fjalë për një depozitë bankare të vitit 2003, - e cila është tërhequr dhe deklaruar më pas dhe është e verifikueshme.⁴⁰

KPA ka konsideruar ‘pasaktësi’ deklaramin e gabuar (*të pasaktë pranë ILDKPKI*), deklaram i cili është korigjuar më pas (*përpara plotësimit të deklaramës vetting*), për faktin se ky korigjim është kryer me iniciativën e subjektit të rivlerësimit – kështu KPA ka çmuar se ‘*mosdeklarami prej subjektit të rivlerësimit i blerjes së automjetit në vitin 2005 është një pasaktësi e bërë në deklaramin periodik të atij viti, i cili është ndrequr në vitin 2009, me vullnetin dhe iniciativën e vetë subjektit të rivlerësimit*’ (shih pikën 67 të Vendimit 20/2019 të KPA).

Kolegji është shprehur për interpretimin harmonik të deklaramave të pasurisë ndër vite dhe deklaramës vetting, pasi Kushtetuta nuk duket të ketë parashikuar nga ana formale apo nga një interpretim harmonik i dispozitave përkatëse në asnjë moment vlerën (primare) të deklaramës së pasurisë (*vetting*) 2017 apo të deklarameve të pasurisë në vite. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rendin e rëndësisë së deklarameve.⁴¹

Gjithashtu lidhur me mënyrën e plotësimit të deklaramës vetting për burimin e krijimit të pasurisë në rastin kur në deklaramat vjetore është treguar burim i ndryshëm, Kolegji mban qëndrimin se; pretendimi i subjektit të rivlerësimit që në momentin e plotësimit të deklaramës së pasurisë (*vetting*) 2017, huaja në fjalë ishte shlyer me të ardhurat familjare në vite dhe për pasojë, ishte e panevojshme të detajohej, nuk qëndron.⁴²

Kolegji arsyeton për pretendimet për standarte të dyfishta; se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimi i duhur i ligjit për situatën konkrete faktike dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera nga Komisioni.⁴³

Provueshmëria e pagesës së detyrimeve financiare të subjekteve të rivlerësimit, ose pasaktësitë në deklaramet e detyrimeve ndaj të tretëve në rastin e subjektit G.O, ka sjellë interpretimin e Kolegjit si vijon: “*Mungesa e dokumentacionit provues ligjor, që do të provonte në mënyrë bindëse vlerën dhe kohën e pagimit të shumës prej 47.680 eurosh përgjatë vitit 2009, do të konsiderohen me vlerë provuese në kuptim të këtij procesi, deklaramet e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaramën periodike të vitit 2009, duke zbatuar në këtë mënyrë parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: Deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të*

⁴⁰ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 112, datë 04.03.2019, faqe 15

⁴¹ KPA, Vendimi Nr. 09 datë 18.04.2019, faqe 24.

⁴² KPA, Vendimi Nr. 9 datë 18.04.2019, faqe 14.

⁴³ KPA, Vendimi Nr. 07/2019 Jr, datë 05.04.2019, faqe 16

paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit. Duke vijuar këtë arsyetim, Kolegji pranon se do të konsiderojë se pagesa e vlerës prej 47.680 eurosh, e kryer në vitin 2009, është realizuar përgjatë këtij viti, deri në datën 31.12.2009, siç ka deklaruar subjekti i rivlerësimit⁴⁴

KPA ka konsoliduar qëndrimin se duhet të marrë në konsideratë të gjitha deklaratimet e bëra të subjekteve të rivlerësimit, në mënyrë që të arrijë në një konkluzion të drejtë bazuar në një kontroll të plotë. Kështu në Vendimin 19/2019, lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë dhe vendin që zë deklarata vetting në raport me deklaratimet periodike të pasurisë ndër vite, KPA ka arsyetuar se “*saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë elementë përcaktues për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë, në plotësimin e kërkesave të normave kushtetuese dhe ligjore të posaçme për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*”.⁴⁵ Ky qëndrim është reflektuar edhe më pas në vendimarrjen e KPA-së, kur argumenton se “*nuk qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit se dokumenti ligjor prej ku fillon përgjegjësia e subjektit për shkelje administrative është deklarata e pasurisë vetting, pasi Kushtetuta nuk ka parashikuar në asnjë moment vlerën (primare) të deklaratës së pasurisë vetting apo të deklaratimeve të pasurisë në vite. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese, rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rëndësinë e secilit prej deklaratimeve, por verifikimi i saktë dhe i plotë i deklaratimeve të subjektit, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklaratimeve vlerën e proves*” (shih para. 4, fq 17 i Vendimit 23/2019). Kolegji në vendimarrjet e tij për subjektet A.C, A.S, A.F dhe B.A, ka afirmuar në jurisprudencën e tij parimin e interpretimit harmonik midis deklaratës vetting dhe deklaratimet pasurore.

5.1.1. Detyrimi për të deklaruar edhe likuiditetet e personave të lidhur/tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, bazuar në marrëdhëniet e posaçme mes tyre

Lidhur me detyrimin për të deklaruar likuiditetet e padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur/tjerë të lidhur me të (*konkretisht të babait të subjektit, në vlerën 1 000 000 ALL*), KPK ka vlerësuar në vendimarrjen e saj se ‘*Subjekti i rivlerësimit, ka pasur për detyrë të deklaronte likuiditetet në çfarëdo formë, por nuk mund të deklaronte ato likuiditete që ishin në administrim të prindërve dhe të familjes së subjektit, pavarësisht nga fakti se familja mund të kishte krijuar kursime edhe për shkak të kontributit të subjektit me të ardhurat nga paga*’ (shih pikën 24/2 të Vendimit 18/2019 të KPA⁴⁶). Lidhur me këtë çështje, Komisioneri Publik në

⁴⁴Kolegji Posaçëm i Apelit Vendim Nr. 20/2019 (JR) datë 31.07.2019, faqe 13-14.

⁴⁵ Kolegji i Posaçëm i Apelit, Vendimi Nr.19/2019

⁴⁶ KPA u vu në lëvizje nga Komisioneri Publik, i cili ushtroi ankim ndaj vendimit të KPK, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe kërkoi kryerjen e një hetimi dhe vlerësimi mbi burimin e ligjshëm, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklaratimit të pasurisë/likuiditetet, pasi sipas

ankimin e tij në KPA ka konstatuar se ‘*subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/tjetër i lidhur me të [babai], nuk kanë deklaruar plotësisht e saktësisht likuiditetet në formën e llogarive bankare bashkëmore në deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, deri në momentin kur subjekti i rivlerësimit, si në aspektin fizik, edhe në atë ligjor rezulton të jetë ndarë nga trangu familjar, ose i kanë deklaruar këto pasuri me mangësi të konstatuara gjatë hetimit të çështjes në KPK qoftë në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën vetting (po aty në vazhdim)*’. KPA ka ndryshuar standardin e vendosur nga KPK (për të njëjtin subjekt) bazuar në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në analizën financiare të zhvilluar nga Njësia e tij, duke vlerësuar se ‘*subjekti i rivlerësimit, ka pasur pasaktësi në deklaratimet e tij, por këto pasaktësi u shpjeguan në kuadër të marrëdhënies së posaçme familjare dhe konfirmimit nga analiza financiare se familja e subjektit, nëpërmjet babait, i cili konsiderohet në këtë rast nga trupi gjykues si person tjetër i lidhur, i ka ‘dhuruar’ shumën prej 1.000.000 lekësh, të përdorura nga subjekti për blerjen e apartamentit; KPA vendosi ta vlerësojë këtë situatë faktike si të mjaftueshme për vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke e konsideruar pasurinë në formën e likuiditeteve, të ardhura të përbashkëta të familjes të subjektit, të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme*’.

Lidhur me justifikimin e shumave të parave të subjekteve të rivlerësimit, të cilat i ka deklaruar si hua të marra nga persona në marrëdhënie të posaçme (familjarë të afërt) për të paguar një pjesë të vlerës së blerjeve të tyre (kryesisht apartamente banimi), KPA, duke konsideruar këto marrëdhëniet e posaçme mes subjekteve të rivlerësimit dhe njëzë të afërt familjarë, ka mbajtur qëndrimin se i konsideron ‘ndihma financiare’ duke arsyetuar se ‘ndihma financiare (prej 20 000 Euro për blerjen e shtëpisë) ka konsistuar në një hua dhe jo dhurim, pra personi tjetër i lidhur nuk ka hequr dorë nga pronësia mbi paratë e dhëna subjektit, por vetëm i ka huazuar ato në formën e një ndihme, duke i rimarrë përsëri në përmbushje të afateve të parashikuara në kontratë; personi tjetër i lidhur rezulton të ketë të ardhura që vijnë nga punësimi dhe që sigurojnë një jetesë modeste, rrethana të cilat mund të kishin një trajtim të ndryshëm në rast se do të kishim të bënim me dhurim të pasurisë. Gjithashtu fakti që personi tjetër i lidhur është treguar aktiv gjatë procesit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin që provon të ardhurat e tij, i cili konsiderohet si dokumentacion/akte që përmban të dhëna personale, çmohet se përmbush, krahas kontratës shkresore, kriterin e konfirmimit të kësaj marrëdhënieje sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e Ligjit 84/2016’ (shih pikën 24 të Vendimit 20/2019 të KPA).

ankimit, hetimi i Komisionit nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së saj, në kuptim të nenit 59, pika 1 e Ligjit nr. 84/2016 (shih pika 7 e Vendimit 18/2019 të KPA).

5.3 Analizat financiare dhe metodologjia e vlerësimit të pasurisë së subjekteve

Ashtu sikurse është konstatuar edhe në raportin studimor të mëparshëm të KShH-së, për vendimet e organeve të vettingut, sërisht vërehet se trupat gjykuese të KPK-së nuk ndjekin të njëjtën praktikë sa i takon pasqyrimin të analizave financiare të detajuara në pjesën arsyetuese të vendimit. Studimi i vendimeve të KPK-së, evidenton raste kur analiza financiare që është pasqyruar në vendim nuk është e plotë. Konkretisht, për subjektin H.D dhe P.Gj në analizën financiare të pasqyruar në vendimin e KPK-së⁴⁷ mungon llogaritja e të ardhurave përpara fillimit të detyrës. Gjithashtu, nuk rezulton e qartë mënyra e përlllogaritjes së kursimeve në vite. KPK ka analizuar vetëm mundësinë reale të subjektit për të krijuar pasurinë për periudhën kohore kur është krijuar, pa marrë në konsideratë kursimet e mbledhura ndër vite. Kjo praktikë është ndjekur dhe në rastin e vendimmarrjes për subjektet e rivlerësimit Xh. Z⁴⁸, B.T⁴⁹.

Evidentimi në mënyrë të rregullt i analizave në pjesën arsyetuese të vendimit, do të shërbente një transparence më të mirë të organeve të vettingut ndaj publikut si dhe do të kontribuonte në konsolidimin e strukturës së vendimeve të KPK-së. Gjithashtu, nga studimi i vendimeve vërehet se mungon një metodologji e unifikuar, me indikatorët dhe nën-indikatorët përkatës, e cila do t'i shërbejë trupave gjykuese në vlerësimin e kriterit të pasurisë që ata bëjnë për këto subjekte. Unifikimi i kësaj metodologjie në vlerësimin e kriterit të pasurisë së çdo subjekti do të kontribuonte në konsolidimin e jurisprudencës së organeve të vettingut si dhe do të shërbente respektimit të parimit të paanshmërisë dhe transparencës, si ndaj subjekteve por edhe publikut. Ky element do të ishte një vlerë e shtuar në forcimin e besimit të publikut.

Kemi mendimin se KPK ose Kolegji, në rastet kur subjektet kanë plotësuar me pasaktësi deklaratat e pasurisë dhe këto pasaktësi nuk kanë pasur për qëllim fshehje të pasurisë, mund të realizonin një hetim administrativ për mundësinë financiare të krijimit të pasurive të tyre, përgjatë gjithë periudhës që ata kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit ose prokurorit. Ky përfundim lidhet me faktin se argumentimi për shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit për arsye të mosplotësimit të kriterit pasuror lidhet kryesisht me mosjustifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave, ose deklaramit të pasaktë. Nga sa më sipër është e nevojshme që të jemi në linjë me sa përcakton Kushtetuta, kur ka sanksionuar masën disiplinore të shkarkimit duke iu referuar termit pasuri dhe jo vetëm të ardhurave.

KPA, në rastin e subjektit të rivlerësimit A.F ka realizuar një analizë financiare lidhur me mundësinë që ky subjekt kishte për të krijuar kursime, pasi në deklaratat e pasurisë të viteve

⁴⁷ Shih vendimin për subjektin H.D, Nr. 108, datë 15.02.2019

⁴⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.46 datë 24.07.2018

⁴⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.14 datë 13.04.2018

2004 dhe 2005 ka pasur pasaktësi.⁵⁰ Kolegji të njëjtin linjë ka ruajtur dhe për subjektin e rivlerësimit A.C dhe ka kërkuar rilogaritjen e të ardhurave për periudhën 15.10.1992-14.07.1994 dhe 10.09.1995-31.08.1997⁵¹. Qëndrimi i Kolegjit se relacioni financiar i përgatitur nga këshilltari ekonomik është një akt këshillimor i trupës, nuk pajtohet plotësisht me qëndrime në vendimmarrje të tjera, ku janë vlerësuar raportet private të përgatitura nga ekspertë mbi vlerësimin e gjëndjes pasurore, por i është dhënë përparësi raportit të hartuar nga vetë këshilltarët e Kolegjit.⁵²

Një element i diskutueshëm në vendimet e studiuara është llogaritja e shpenzimeve të jetesës, që referon në llogaritjen që INSTAT realizon për vlerën e shpenzimeve mesatare të jetesës. Indeksi mesatar i shpenzimeve i përcaktuar nga INSTAT nuk pasqyron shpenzimet reale dhe efektive të subjekteve, pasi metodologjia e përllogaritjes së këtij zëri ka në konsideratë shumatoren e pagave minimale me ato maksimale. Ky indeks i referohet shpenzimeve në rang mesatar kombëtar dhe jo individual. Organet e vettingut në të dyja shkallët e kanë konsoliduar praktikën duke iu referuar llogaritjes së shpenzimeve mesatare sipas INSTAT.⁵³

Në shumicën e vendime të analizuara, KPK ka kryer analizën financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e subjekteve të rivlerësimit dhe familjarëve të tyre, duke parashtruar pa referenca të sakta llogaritjen e shpenzimeve të jetesës në vlerën 26% të të ardhurave, ndërkohë që në studimet e INSTAT ndër vite për shqiptarët kjo vlerë llogaritet rreth 40-44% të të ardhurave të tyre familjare. Kështu KPK në Vendimin 22/2018 (fq. 8) parashtron se “shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit për periudhën 1992-2000 janë llogaritur përafërsisht, duke marrë në konsideratë nivelin e pagave gjatë kësaj periudhe, përbërjen familjare të subjektit, dhe si shpenzim mujor një vlerë e përafërt që zë rreth 26% të totalit të të ardhurave”.

Në një rast tjetër, në Vendimin 62/2018 të KPK-së, lidhur me analizat financiare të depozitimeve dhe pakësimeve/tërheqjeve të vlerave monetare nga bankat e kursimit i referohet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për burimin e krijimit të tyre, referuar të dhënave bankare (*statement*) për bankat e nivelit të dytë nga ku ata kanë kërkuar informacion, në raport me deklaratat e tyre në ILDKPKI dhe Deklaratat Vetting (*shih analizën e KPK fq. 16-22*) – problematika e vërejtur në këtë drejtim lidhet me faktin se secila nga këto llogari analizohet e veçuar përgjatë gjithë periudhës së deklarimeve, ndërkohë që këto analiza mund të kryeheshin gjithashtu në mënyrë integrale. Kështu, për secilin subjekt rivlerësimi apo persona të lidhur me të mund të vlerësohej burimi i krijimit të tyre, nga të gjitha bankat në mënyrë të agreguar për të gjitha vitet e deklarimit, me qëllim që të analizohej më qartë nëse subjektet kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e të ardhurave, si kanë ecur shpenzimet brenda po atj viti, pra sa janë

⁵⁰ Kolegji I Posaçëm I Apelimit, Vendimi Nr.9 datë 18.04.2019, faqe 16.

⁵¹ Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr.05, datë 18.02.2019, faqe 17.

⁵² Shih vendimin Nr. 08, datë 16.04.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Vendimi Nr. 09 datë 18.04.2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁵³ Vendimi Nr. 138, datë 09.04.2019

kredituar ose debituar llogaritë në total dhe a ka pasur mundësi subjekti të kryejë pagesa në vlera të mëdha.

Nga vendimet e analizuara rezultojnë se në analizën financiare janë marrë në konsideratë shpenzimet për jetesë, kostot e udhëtimeve, shpenzimet që i kalojnë vlerën 300,000 Lekë dhe për rastet kur subjekti i rivlerësimit nuk i ka pasqyruar në deklaratat vjetore.⁵⁴ Në raste të tilla, organet e vettingut kanë mundësinë të drejtohen institucioneve përkatëse bankare për të kërkuar informacion mbi gjëndjen e llogarive konform nenit 50 pika ç të ligjit Nr. 84/2016. Megjithatë për subjektin P.Gj mungon një analizë e mirëfilltë e shpenzimeve të deklaruara ndër vite dhe mundësisë për të pasur të ardhura të justifikuar me burime të ligjshme.⁵⁵ Për vlerën, shpenzime që kalojnë shumën 300,000 Lekë dhe mënyrën e deklarimit të tyre, KPK ka konstatuar se, arritja ose jo e pragut që pasjell detyrimin ligjor për deklarimin e tyre, duhet të përlllogaritet në totalin e shpenzimit përkatës, të kryer në harkun kohor të vitit për të cilin referon deklarata e paraqitur nga subjekti, dhe nuk rezultojnë korrekte mënyra e analizimit veçmas dhe në vetvete për çdo shpenzim apo blerje të kryer brenda vitit deklarues, edhe kur ato i përkasin të njëjtës kategori shpenzimi.⁵⁶

5.3.1 Vlerësimi i konceptit ‘pasuri në përdorim’ i subjekteve të rivlerësimit, si detyrim për t’u deklaruar si interes pasuror

Përgjatë vendimeve të monitoruara të KPA, rezultojnë që të jetë përdorur edhe një tjetër koncept lidhur me pasurinë, ai i ‘pasurive në përdorim’, të cilin KPA e lidh kryesisht me pasjen e një interesi pasuror ose ekzistencën e një konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe personit që ka në pronësi pasuritë që ata kanë përdorur për periudha të ndryshme kohore. Kështu KPA ka vlerësuar se *‘duke qenë se në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë (vetting) nuk provohet nga aktet e fashikullit gjyqësor se subjekti ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, sikundër dhe nuk rezultojnë që të ketë pasur një policë sigurimi TPL të vlefshme në këtë moment kohor, trupi gjyqësor arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e Ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim, dhe se çdo pasaktësi në deklaratimet periodike të viteve të mëparshme, në drejtim të mosdeklarimit të interesit pasuror në formën e përdorimit të automjetit në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, për sa kohë nuk rezultoi gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe atij gjyqësor në Kolegj ndonjë e dhënë në drejtim të ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi mes subjektit dhe shoqërisë në fjalë, këto pasaktësi nuk mund të vlerësohen si deklarim i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe si të tilla të mund ta bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit në këtë drejtim’ (shih pikën 24.3 të Vendimit 11/2019 të KPA).*

⁵⁴ KPK, Vendimi Nr.138 datë 09.04.2019, faqe 21; Vendimi Nr.138 datë 09.04.2019

⁵⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.116 datë 21.03.2019

⁵⁶Ibid, faqe 15

Në vendimmarrjen e KPK-së për subjektin e rivlerësimit L.H, konkludohet se nuk u provua me dokumentacion ligjor, burimi i ligjshëm i të ardhurave të personit tjetër të lidhur shtetasit B. H., për blerjen e këtij automjeti nga personi tjetër i lidhur, A. H.⁵⁷ Hetim i burimit të ligjshëm të pasurisë së personit të lidhur, mbart diskutimin nëse i tejkalon ose kufijtë e parashikuar nga kompetencat që ligji i ngarkon institucioneve të vettingut, në kryerjen e hetimit administrativ.

5.3.2 Provueshmëria e të ardhurave të fituara para fillimit të detyrës dhe përmbushja e detyrimeve tatimore

Aneksi kushtetues ka përcaktuar detyrimin për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur për provueshmërinë e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të krijuara përpara fillimit të detyrës. Megjithatë, një pjesë e subjekteve si dhe personave të lidhur me ta, për shkak të moshës apo përvojave të gjata dhe të ndryshme që kanë patur para fillimit të detyrës së subjektit, kanë hasur në vështirësi për të provuar me dokumentacion, ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të krijuara. Ky proces është vështirësuar gjithashtu edhe për shkak të informalitetit të lartë të ekonomisë shqiptare në një periudhë të gjatë tranzicioni, sidomos në dy dekadat e para të saj. Edhe kuadri ligjor financiar në këtë periudhë por dhe më pas, ka pësuar një sërë ndryshimesh që kanë synuar të adresojnë pikërisht rregullimin e informalitetit të ekonomisë në vend. Kjo mund të jetë një nga arsyet që ka shtyrë legjislatorin të vendosë një dispozitë që parashikon pamundësinë objektive të subjektit *për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive (neni 32, pika 2 e ligjit nr.84/2016)*. Por edhe në këto raste, subjekti duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Vlerësimi nëse subjekti është në kushtet e pamundësisë i takon institucioneve të rivlerësimit, të cilat vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme.⁵⁸

Në një prej vendimeve të KPA-së,⁵⁹ argumentohet se pasuritë e vëna nga subjekti i rivlerësimit, aq më tepër prej personave të lidhur, para periudhës së rivlerësimit, mund të plotësojnë e kënaqin nivelin diskrecionar për “justifikimin bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurive” edhe për një nivel më të ulët të provave.

Nje element tjetër i diskutueshëm në vendimet e studiuara është justifikimi ose jo i të ardhurave për të cilat, subjekti apo personi i lidhur me të, nuk ka paguar tatim në burim. Në rastin e subjektit të rivlerësimit D.P, KPK vlerëson se mospagimi i taksave për një pjesë të të ardhurave ka qenë detyrim i punëdhënësit dhe se ato nuk mund të paguheshin nga vetë subjekti. Marrëdhënia e punësimit të subjektit sipas KPK-së është e ligjshme dhe të ardhurat e përfituara

⁵⁷ Po aty, faqe 12

⁵⁸ Ligji Nr. 84/201624, neni 32/2.

⁵⁹ Kolegji i Posaçëm i Apelit, Vendimi Nr 6, datë 28.02.2019, faqe 36

kanë qenë nga një marrëdhënie pune e ligjshme.⁶⁰ Ndërkohë, për subjektin E.S, KPK ka mbajtur një qëndrim ndryshe duke konstatuar se në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar si të ardhura të bashkëshortes së tij vlerë më të lartë nga sa punëmarrësi i saj kishte deklaruar në organet përkatëse tatimore.⁶¹ Subjekti në rastin konkret ka pretenduar të ardhurat që realisht ka marrë dhe jo të ardhurat të cilat punëdhënësi ka deklaruar në organet tatimore.⁶² Për të njëjtin subjekt, KPA, njësoj si KPK ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke vendosur lënien në fuqi të vendimit për shkarkimin e tij nga detyra. KPA, në një rast të ngjashëm konkludon ndryshe, duke arsyetuar se *“për të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga shërbimet e tij në Mbretërinë e Arabisë Saudite gjatë vitit 2006, nuk u arrit të provohet se janë përmbushur detyrimet tatimore përkatëse dhe për rrjedhojë, ato nuk përmbushin kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi”*.⁶³

Në vendimet e studiuara vërehet se ka subjekte të cilët kanë hasur në vështirësi për të provuar ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave të tilla si, ato nga emigracioni, të cilat mund të jenë krijuar shumë vite më parë nga subjekti apo personat e lidhur me të, por që nuk kanë pasur detyrimin ligjor për ruajtjen e dokumentave. Neni 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton konceptin e ardhur e ligjshme, referon në kategoritë e burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin *“Mbi tatimin mbi të ardhurat”*. Neni 4 i këtij ligji (8438/1998) klasifikon burimet e të ardhurave në vendin tonë të tilla si; të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar brenda vendit, të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale brenda vendit, [...] **të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë dispozitë**. Në këtë kontekst, të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion, por që jo gjithmonë mund të jetë paguar tatimi mbi të ardhurat, ose ky tatim mund të jetë deklaruar jo në vlerën e tij reale, ka krijuar për subjektet e rivlerësimit një debat ligjor dhe fiskal.

Në rastin e subjektit R.P, KPK, lidhur me të ardhurat e krijuara nga emigracioni ka argumentuar se, *“të ardhurat janë realizuar shumë kohë para miratimit dhe hyrjes në fuqi të paketës Kushtetuese të Reformës në Drejtësi, duke përfshirë dhe ligjin nr. 84/2016, të cilët përcaktuan rregulla specifike në drejtim të provueshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të siguruara nga subjektet e rivlerësimit, për efekt të kontrollit e verifikimit të pasurive të tyre. Ky burim të ardhurash është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit që në deklarin për herë të parë në vitin 2003. Për më tepër, këto të ardhura kanë qenë të depozituara në sistemin bankar që në vitin 1998, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave vetëm në funksion të deklarimit “Vetting”....*⁶⁴ Për më tepër, arsyetimi vijon se, subjekti nuk kishte detyrim për ruajtjen e dokumentacionit, përse kohë që detyra e saj si gjyqtare ka filluar në vitin 2000 dhe

⁶⁰ Komision i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr. 103, datë 05.02.2019, faqe 9, shih gjithashtu faqen 11-12 të vendimit

⁶¹ Kolegji I Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr. 7 datë 05.04.2019, faqe 11

⁶² Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr.7 datë 08.04.2019

⁶³ Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi Nr 6, datë 28.02.2019, faqe 23

⁶⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 169 datë 26.06.2019

duke marrë në konsideratë faktin e kalimit të një periudhe kohore kaq të gjatë; ka pranuar kërkesën për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga detyrimi për paraqitjen e dokumenteve që justifikojnë ligjshmërinë e krijimit të pasurive, sipas nenit 32, pika 2, e ligjit nr. 84/2016 duke vlerësuar edhe të gjitha përpjekjet e tij për të provuar deklaratimet e bëra.⁶⁵

Për justifikimin e burimit të ligjshëm të pasurisë në një praktikë tjetër Komisioni arsyeton se: *“Nga përmbajtja e këtij vërtetimi konstatohet se subjekti është në pamundësi objektive për të vërtetuar fitimin neto të biznesit të znj. A. B. S. në momentin e dhënies së huasë. ... Për rrjedhojë, nisur nga fakti se për periudhën 2003 – 2006, ky subjekt tregtar ka pasur qarkullim total për të cilin është paguar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin si dhe nisur nga fakti që dhënia e huas është bërë vetëm për një afat njëmuor, Komisioni krijoi bindjen se znj. A. B. S., ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për dhënien e huas në datën 29.7.2006, duke e konsideruar të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit”*.⁶⁶

*Sipas doktrinës pagimi i taksave nuk ligjëron pasurinë, ose të ardhurat, ashtu sikurse mospagimi i detyrimeve tatimore nuk e cilëson pasurinë si të jashtëligjshme.*⁶⁷ Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë dhe pagimin e tatimeve (detyrimeve fiskale) për krijimin e saj, KPA ka mbajtur qëndrim krejt të ndryshëm me KPK; duke arsyetuar se *“jo çdo pasuri për të cilën nuk është paguar detyrimi fiskal, duhet të kualifikohet apriori e paligjshme, pasi mundet që subjekti i rivlerësimit të shpjegojë bindshëm dhe të sjellë prova që vërtetojnë të kundërtën’ ... dhe vazhdon .. ‘megjithëse detyrimi fiskal për një pasuri mund të mos jetë paguar, burimi i krijimit të saj mund të rrjedhë nga një punë apo veprim juridik që ligji nuk e ndalon apo e lejon në mënyrë të shprehur. Për KPK ‘mospagimi i detyrimeve fiskale mundet të konsiderohet si shkelje e etikës së magistratit apo shkelje administrative, por nuk mund të shërbejë si shkak për dhënien e masave disiplinore në bazë të nenit D të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore të dala në zbatim të saj’ (shih Vendimin 46/2018 të KPK, fq. 27/1). Për të njëjtin subjekt rivlerësimi KPA ka mbajtur një qëndrim të kundërt me KPK, kur ka vlerësuar se *“në kontekstin e procesit të rivlerësimit, deklarimi i saktë dhe i plotë i burimit të krijimit të pasurisë dhe të ardhurave, si dhe ligjshmëria e këtij burimi është kusht thelbësor për të kaluar testin e kriterit të vlerësimit të pasurisë. Për këtë qëllim, subjektet duhet të paraqesin dokumentacion provues mbi përmbushjen e detyrimeve tatimore; në të kundërt, burimi, e ardhura dhe pasuria e krijuar do të konsiderohen të paligjshme dhe, për rrjedhojë, krijohen kushtet e pamjaftueshmërisë për kriterin e kontrollit të pasurisë”* (shih pika 22.12 dhe 22.13 e vendimit 19/2019).*

⁶⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr.169, faqe 90

⁶⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.151, faqe 10

⁶⁷ Komentari mbi Reformën Kushtetuese në sistemin e Drejtësisë, botuar më 2019, faqe 532

5.3.3 Linja e mbajtur për konceptin e “fshehje e pasurisë”

Zbatimi i drejtë i parimit të proporcionalitetit nga organet e vettingut kërkon një qartësim dhe unifikim të praktikës së KPK-së dhe të KPA-së se çfarë do të konsiderohet fshehje e pasurisë dhe kur pasaktësitë në plotësimin e deklaratave apo mosdeklarimi nuk përbëjnë fshehje. Konkretisht, për subjektin (D.P), pasaktësitë në plotësimin e deklaratave pasurore, kanë çuar në vlerësimin se një harrese apo mosdeklarim, pa pasoja fshehjeje, nuk mund të passjellë automatikisht një përgjegjësi të tillë, që të çojë në aplikimin e një mase për deklaruesin.⁶⁸ Vlerësimi i pamjaftueshmërisë së deklaratimit kërkon një vlerësim diskrecionar të organit të rivlerësimit,⁶⁹ dhe kërkon si shkak ekzistencën e motivit apo përpjekjes për të fshehur pasurinë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Për subjekte të tjera në situata të ngjashme, qëndrimi i KPK-së apo i KPA-së rezulton i ndryshëm, pasi është arsyetuar se vlerësimi financiar duhet të kryhet jo vetëm nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit (vendimet për subjektet A. F⁷⁰, D. S⁷¹, A.K⁷²). Në këto raste, organet e vettingut kanë vlerësuar se mosplotësimi i deklaratave përbën pasaktësi dhe për subjektet është zbatuar masa e shkarkimit sipas nenit 61 të Ligjit 84/2016.

Analiza e dispozitave të aneksit kushtetues dhe të ligjit të vettingut, evidenton se nuk ka një harmonizim të plotë midis tyre, sa i takon koncepteve “fshehje e pasurisë” dhe “deklarim i pasaktë i pasurisë”. Në nenin D të aneksit Kushtetues pika 5 e tij, parashikohet se “Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket **të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë** në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Pra në dispozitën kushtetuese, “deklarimi i pasaktë” përbën një koncept të ndryshëm ose alternative të konceptit “fshehje pasurie”. Ndërkohë, në nenin 61, pika 3 të ligjit nr.84/2016, kur flitet për masën e shkarkimit se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm, dispozita referon në nenin 33 të të njëjtit ligj, i cili në pikën 5 të tij parashikon “fshehjen e pasurisë” apo “deklarimin e rremë”, por jo “deklarimin e pasaktë”. Në këtë prizëm, këto formulime disi konfuzë janë reflektuar edhe në praktikën e organeve të vettingut, për shkak se ende koncepti i “fshehjes së pasurisë” është i paqartë; a do të jetë “deklarimi i pasaktë” në çdo rast fshehje e pasurisë, si nga pikëpamja e elementëve por edhe e pasojës, dhe rrjedhimisht shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit?

⁶⁸ Vendimi Nr. 112 datë 04.03.2019, faqe 15

⁶⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 40 datë 17.07.2018

⁷⁰ Kolegji i Posaçëm i Apelimit Vendimi Nr.09 datë 18.04.2019

⁷¹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.114 datë 11.03.2019

⁷² Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr.113 datë 08.03.2019

5.4 Shkarkimi kur është deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme të subjektit

Neni 61, pika 1 e ligjit nr.84/2016 parashikon vendosjen e masës së shkarkimit, në rastin kur subjekti rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, duke përfshirë edhe personat e lidhur me atë. Në kampionët e vendimeve të organeve të vettingut që janë marrë për studim, edhe pse ka patur disa vendime të shkarkimit për shkak të kriterit të pasurisë, nuk vërejmë ndonjë rast kur subjektet të kenë deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe rrjedhimisht të jenë shkarkuar sipas kësaj dispozite.

Pavarësisht nga përmbajtja e nenit 61, pika 1 e ligjit nr.84/2016, dispozitat që krijojnë hapësirë lidhur me zbatimin ose jo të “kufirit të justifikimit të pasurisë” si bazë ligjore për shkarkimin nga detyra, janë pikat 3 dhe 5 të po të njëjtës dispozite. Psh, sipas nenit 61, pika 5 të këtij ligji, subjekti mund të shkarkohet edhe kur është në kushtet që nuk justifikon më pak se dyfishi i pasurisë së ligjshme, por kur shkeljet e kryera në këtë drejtim mund të cenojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Ndërkohë, referuar doktrinës, pika 5 e nenit 61 duhet të zbatohet në rastet kur cënimi i besimit të publikut tek subjekti ka ardhur pasi janë vlerësuar në mënyrë tërësore (kumulative) të treja kriteret së bashku dhe nuk mund të jetë duke u bazuar vetëm në një kriter.⁷³

5.5 Deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë

Në nenin 61, pika 3 të ligjit nr.84/2016 parashikohet dhënia e masës së shkarkimit ndaj subjektit kur rezulton se ai/ajo ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 39 të këtij ligji. Lidhur me zbatimin e kësaj dispozite, nga vendimet e studiuara është vërejtur se nuk është mbajtur i njëjti qëndrim për subjekte të ndryshëm. Megjithatë, vlen të nënvizojmë se rrethanat faktike të subjekteve nuk janë të njëjta, pavarësisht dozës së ngjashmërisë e cila mbart në vetëvete hapësira për vlerësime subjektive.

Në vendimmarrjen e KPK-së për subjektin D.P konkludohet se; kur nga një analizë financiare që i referohet një segmenti kohor prej rreth dy dekadash, rezulton një mungesë financiare minimale, e shpërndarë ndër vite, ajo mund të tolerohet, jo vetëm për mundësinë e ndonjë pasaktësie në parametrat e përdorur përgjatë procesit të përlllogaritjeve, por edhe në funksion, pikërisht, të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, duke çmuar se nuk konstatohen elementë të majftueshëm që të çojnë në aplikimin e masës së parashikuar në pikën 1/c të nenit 58.⁷⁴

⁷³ Komentar mbi Reformën Kushtetuese në Sistemin e Dretjësise, Instituti për Studime Politike dhe Ligjore & Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, faqe 540-541

⁷⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr. 112 dt 04.03.2019, faqe 31,

Gjithashtu, për subjektin E.T konstatohet se megjithëse subjekti nuk ka kryer deklarin e gjendjes cash për periudhën 2012-2016, nga ana e Komisionit ky fakt në vetvete ka qenë i pamjaftueshëm për të pasjellë zbatimin e shkaqeve ligjore për shkarkim të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016.⁷⁵ Pasaktësitë në deklarin nga subjekti nuk gjykohen se çënojnë vlerësimin e pasurisë së tij.⁷⁶ Gjithashtu në vijim të justifikimit të pasaktësive në deklarin konkludohet se; mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.⁷⁷

I njëjti argument nuk është ndjekur në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit A. K, për të cilin trupa gjyquese e KPK-së vlerëson se mosdeklarin i të drejtave reale të pronësisë në deklarin periodik për vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, për tetë pasuritë e përfituara nga shoqëria “****” sh.p.k, është pasaktësi me pasojë deklarin të pamjaftueshëm të pasurive nga ana e subjektit, dhe duhet të merret në konsideratë, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes.⁷⁸ Gjithashtu për subjektin H. D⁷⁹ trupa gjyquese e KPK-së mban qëndrimin se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, përse i takon vlerësimit të kriterit të pasurisë, duke theksuar se nuk ka pasur mundësi financiare për të shlyer këstet e kredisë në vite.⁸⁰

Ndërkohë, KPA, në ndryshim nga linja e mbajtur nga KPK ka vendosur standardin se *‘mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet (vetëm) për vitet 2011 dhe 2013 e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e Ligjit 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm, si një kriter që justifikon zbatimin ndaj tij të masës disiplinore, shkarkim nga detyra’ (shih pikën 79 të vendimit 20/2019 të KPA).*

Gjithashtu, edhe në një rast tjetër KPA arriti në konkluzionin se *“për sa kohë nuk u arrit të provohet burimi i krijimit të të ardhurave të deklaruara gjatë shqyrtimit gjyqësor se kanë shërbyer si burim për krijimin e tri pasurive të paluajjtshme, ... subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëjetuesja e tij) kanë kryer deklarin të paplotë të tri pasurive në deklaratën e pasurisë (vetting) dhe atë periodike vjetore të vitit 2005, sa i takon burimit të krijimit, deklarin të pasaktë në deklaratën e pasurisë (vetting) të të ardhurave nga puna, si dhe ndodhen në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar të tria këto pasuri të paluajjtshme, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe Ligjit 84/2016’ (shih pikën 20.13 të vendimit 11/2019 të KPA).*

⁷⁵ Ibid, faqe 18.

⁷⁶ Ibid, faqe 23-24

⁷⁷ Ibid, faqe 32.

⁷⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 113 datë 08.03.2019

⁷⁹ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 108, datë 15.02.2019, faqe 29

⁸⁰ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 108 datë 15.02.2019, faqe 29

Edhe në një rast tjetër, KPA ka argumentuar se ‘trupi gjykues’⁸¹ arrin në konkluzionin se “subjekti i rivlerësimit ka kryer **deklarim të paplotë dhe të pasaktë** të pasurive të tij në deklaratën e pasurisë (vetting) në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, **me qëllim shmangien nga kontrolli**, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ... “.

6. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjekteve

Ashtu si në raportet e kaluara studimore të KShH-së, edhe në këtë raport vërehet se, në jurisprudencën e deritanishme të organeve të vettingut nuk ka patur subjekte të shkarkuar vetëm për shkak të kriterit të aftësive profesionale. Megjithatë, ka patur vendime kur shkarkimi është bërë për më shumë se një kriter si psh kriteri i pasurisë gërshetuar me atë të aftësive profesionale.⁸²

Në analizën për kriterin e aftësive profesionale të subjekteve, për arsye të vonesave në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë, Komisioni dhe Kolegji janë mbështetur në relacionet e hartuara nga organet ndihmëse “tranzitore”, KLD dhe Prokuroria e Përgjithshme, të cilat kanë parashtruar në relacionet e tyre përkatësisht për gjyqtarët dhe prokurorët, të dhëna për aftësitë profesionale. Por ndërkohë, pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë, në Dhjetor të vitit 2018, është vërejtur se gjatë procesit të rivlerësimit janë kërkuar relacione nga të dy Këshillat, sa i takon aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësuaras pas ngritjes së tyre (shih vendimet për subjektet A.B, E.XH, dhe R.B, etj⁸³). Ajo që vihet re është fakti se raportet e hartuara nga KLD e mëparshme kanë shërbyer si pikë mbështetje për realizimin e raportit përfundimtar të KLGJ-së. Megjithatë është e paqartë, përse ka lindur nevoja për të dubluar relacionet e organeve tranzitore për aftësitë profesionale të subjekteve me relacionet e marra nga të dy Këshillat.

Një aspekt i rëndësishëm për këtë kriter vlerësimi janë denoncimet e publikut. Qytetarët, nëpërmjet procesit të vettingut kanë paraqitur pranë institucioneve të vettingut të dhëna, informacione apo dokumentacion që provon shkeljet profesionale të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët. Në përgjithësi, vërehet se nuk ka patur denoncime me peshë të konsiderueshme dhe që të çojnë në shkarkimin e subjektit. Përrjashtimisht, për subjektin e rivlerësimit A. Ç, trupa gjykuese e KPK-së ka marrë në konsideratë në vlerësimin e aftësive profesionale dhe etikës së subjektit, ndër të tjera dhe dy denoncime anonime të adresuara nga qytetarët. Pas hetimit të

⁸¹ Në periudhën e analizuar nga Kolegji, për vitet 2004-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, në vlerën prej 4.367.802 ALL (shih pikën 27.13.3 të vendimit 11/2019 të KPA).

⁸² Vendimet për shkarkim për arsye të mospërbushjen e kriterit të aftësive profesionale dhe pasurisë janë dhënë për subjektin A. Gj, Vendimi Nr. 100 datë 14.01.2019; Subjekti E. A, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit; Vendimi Nr. 137 datë 09.04.2019; Subjekti H.D Vendimi Nr. 108 datë 15.02.2019.

⁸³ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit Vendimi Nr. 143 dt 26.04.2019, Vendimi Nr. 141 dt 18.04.2019, Nr. 135 dt 05.04.2019

realizuar kryesisht lidhur me këto denoncime, trupa gjyqësore vlerëson se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, qoftë edhe në dukje, duke cenuar rëndë etikën dhe figurën e gjyqtarit dhe në vlerësimin tërësor ka vendosur shkarkimin e subjektit.⁸⁴

Për subjektin D.S, denoncimet e publikut janë marrë në konsideratë gjatë analizës së kriterit të aftësive profesionale nga trupa gjyqësore e KPK-së, por ato nuk kanë çuar në shkarkimin e tij. Në vendimin e dhënë për këtë subjekt, evidentohen raportet e përgatitura nga ish KLD, për periudhën 2007- 2010, nga ku ka rezultuar se subjektit i janë cënuar 27 vendime gjyqësore nga gjykatat më të larta.⁸⁵ Megjithatë, referuar vendimeve të gjykatës kushtetuese dhe standarteve të gjyqësorit, prishja apo ndryshimi i një vendimi të një gjykate më të ulët nga një gjykatë më e lartë, jo detyrimisht përbën shkelje të natyrës profesionale ndaj gjyqtarit apo trupës gjyqësore që e ka dhënë. Për këtë subjekt është konkluduar se është “i aftë” duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.⁸⁶

Qënia e subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, është vlerësuar nga KPK si cenim i rëndë i etikës dhe figurës së gjyqtarit. Konkretisht, në vendimin nr.95, dt.08.01.2019, KPK vëren se subjekti, së bashku me bashkëshorten e tij, i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me objekt fitimin e pronësisë, ndërkohë që në këtë gjykatë, vetë subjekti/pala paditëse është kryetar i saj. KPK çmon se subjekti ka cenuar figurën e gjyqtarit, duke ushtruar veprimtarinë e tij si kryetar i gjykatës në kushtet e konfliktit të interesit. Në të njëjtën kohë ai ka cenuar besimin e publikut për një drejtësi të pavarur dhe të paanshme.

Në një vendimmarje tjetër të Komisionit ekzistenca e konfliktit të interesit dhe zgjidhja e pasojave është argumentuar se “*Mënjanimi apo parandalimi i konfliktit të interesit nga zyrtari lidhet me dijeninë e tij për situatën dhe rrethanën që e krijon atë, gjendur në këto kushte subjekti më anë të tjetërsimit të interesave privatë, duke dhuruar aksionet në emër të tij dhe bashkëshortes, bëri të mundur zgjidhjen e situatës së konfliktit të interesit në momentin që mori dijeni*”.⁸⁷ Pavaresisht nga fakti që shoqëria ka marrë pjesë në tender apo ka lidhur kontrata, subjekti nuk ka pasur rol vendimmarres duke qenë se vlera e aksioneve ka qenë e papërfillshme dhe për këtë arsye nuk provohet asnjëloj konflikti.⁸⁸

Interpretimi i rasteve të konfliktit të interesit për subjektet e rivlerësimit ka sjellë ndasi në radhët e anëtarëve të trupave gjyqësore të KPK-së. Konstatohet se në rastin e subjektit të rivlerësimit K.S, anëtari në pakicë i trupës gjyqësore shprehet se: “*Në çdo proces gjyqësor, në të cilin njëra nga palët është institucioni ku personi i lidhur me subjektin punon, pavarësisht faktit nëse personi i lidhur ka kontakte direkte apo indirekte me subjektet tregtare që janë palë në proces, pavarësisht nëse në këtë proces gjyqësor janë ankimuar akte që mund të mos jenë*

⁸⁴ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 95, datë 08.01.2019, faqe 44

⁸⁵ Komisioni I Pavarur I Kualifikimit Vendimi Nr. 114, datë 11.03.2019, Faqe 34

⁸⁶ KPK, Vendimi nr. 114, datë 11.03.2019, ft. 40

⁸⁷ Ibid, faqe 16

⁸⁸ Ibid

*firnosur nga ajo, vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është tërësisht e paragjykuar, si në sytë e palës tjetër ndërgjyqjese, ashtu edhe në sytë e publikut, sepse për shkak të lidhjeve familjare me subjektin duket sikur do të anojë nga krahu i palës ndërgjyqjese ... Në përfundim, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë zhvilluar procese gjyqësore dhe të ketë marrë vendime në situatën e konfliktit faktik dhe atij në dukje të interesit, në mënyrë të vazhdueshme, duke sjellë si pasojë cenimin e besimit të publikut te drejtësia”.*⁸⁹

KPA, në vendimin nr.21/2019, për herë të parë ka elaboruar standardet dhe metodologjinë lidhur me zbatimin e kriterëve për vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit (adresuar fillimisht nga vëzhguesi i ONM-së, i cili i ka paraqitur rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, duke identifikuar gjetje dhe mangësi në lidhje me çështjet e marra në vlerësim nga KPK për kriterin e aftësive profesionale - *shih fq. 3-4 të Vendimit 21/2019 të KPA*). Në ankimin e tij, Komisioneri i ka kërkuar Kolegjit të arsyetojë në vendimmarrje dhe **orientimin që duhet të ketë KPK mbi mënyrën e rivlerësimit të aftësisë profesionale, bazuar jo vetëm në raportet e hartuara nga organet ndihmëse të këtij procesi, por duke u bazuar dhe në metodologji konkrete, në plotësim dhe të gjithë indikatorëve dhe nënindikatorëve ligjorë të përcaktuar nga Ligji nr. 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSh’ (shih para. 7.4 dhe 10.1 të Vendimit)**. Në vendimin 21/2019 të KPA-s janë analizuar një sërë nën-indikatorësh mbi bazën e të cilëve do të duhet të realizohet vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, praktikë kjo që duhet të ndiqet jo vetëm nga kolegjet e tjera të KPA por edhe nga KPK, **kur është e mundur dhe e nevojshme** (para. 26).

Kriteret që përmblihen në vendim janë ato që parashikohen nga ligji, të tilla si⁹⁰:

1. aftësia për të gjykuar;
2. aftësia organizative,
3. etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore; dhe
4. cilësitë personale dhe angazhimi profesional, në përputhje me standardet e parashikuara në ligj

Përgjatë vendimit analizohet me detaje vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit lidhur me nën-kriteret e tjera shtesë, në funksion të kriterëve të përgjithshme të tilla si:

- **njohuritë ligjore dhe arsyetimit ligjor**⁹¹

⁸⁹ Ibid, faqe 96-97

⁹⁰ Referuar Nenit E, pika 2, fjalia e dytë të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, në objektin e vlerësimit të aftësisë për gjyqtarët, ku përfshihen kriteret e aftësitë për të gjykuar, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimi profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj (Ligji nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe me referim për procedurat e vlerësimit nga ky i fundit edhe në Ligjin 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSh’

⁹¹ Ky kriter duhet të vlerësohet bazuar në aftësi të tilla si: aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe aftësia për të analizuar jurisprudencën (para. 19.3.1) dhe qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik (para. 19.3.2)

- **aftësitë organizative**⁹², duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit
- **etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**⁹³
- **kriteri i aftësisë personale dhe angazhimit profesional**⁹⁴

Gjithashtu, një praktikë e re e evidentuar në kuadrin e grumbullimit të provave për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit është edhe fakti se gjatë shqyrtimit gjyqësor në të njëjtin vendim (21/2019), KPA kërkoi nga institucionet përkatëse që të administrojnë në dosjen gjyqësore edhe:

1. dosjen personale të magistratit;
2. mendimin e kryetarit të Gjykatës si dhe informacionin me shkrim nga Shkolla e Magistraturës, praktikë kjo që do të duhet të ndiqet edhe për rastet e mëtejshme në vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.

7. Vlerësimi i pastërtisë së figurës së subjekteve

Nga analiza e ekspertëve të KShH-së, rezulton se dy subjekte janë shkarkuar nga detyra për kriterin e pastërtisë së figurës ose siç njihet ndryshe kontaktet e papërshtatshme me krimin e

⁹² Ky kriter duhet të vlerësohet në drejtim të:

- aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës, e cila matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore (para. 19.4.1),
- aftësisë për të kryer procedurat gjyqësore, e cila matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, (para. 19.4.2) dhe
- aftësisë për të administruar dosjet gjyqësore, e cila matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes (para. 19.4.3)

⁹³ Ky kriter duhet të vlerësohet nëpërmjet:

- etikës në punë, e cila matet duke u bazuar në treguesit e dalë nga burimet e vlerësimit, të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre, mendimi i kryetarëve dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës përkatëse të vlerësimit (para. 19.5.1)
- integritetit të magistratit, në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm (para. 19.5.2)
- paanësisë së magistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë, matet duke u bazuar në tregues të tillë, si: përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e magistratit (para. 19.5.3).

⁹⁴ Ky kriter duhet të vlerësohen nëpërmjet:

- aftësive të komunikimit që matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit të qartë dhe transparent me palët gjyqësore, publikun, subjektet e tjera, të tretët, në respektim të konfidencialitetit dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale (para. 19.6.1).
- aftësisë për të bashkëpunuar me kolegët që matet duke u bazuar në treguesit e komunikimit dhe bashkëveprimin me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe në shkëmbimin e njohurive apo të përvojës profesionale me ta (para. 19.6.2), dhe
- gatishmërisë për t'u angazhuar në veprimtari të tjera si: pjesëmarrja e magistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magistratëve të rinj, pjesëmarrja e magistratit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike (para. 19.6.3 & 4).

organizuar, përkatësisht për subjektin A. Z dhe A.F. Vendimmarrja e institucioneve të vettingut përsa i takon pastërtisë së figurës është mbështetur kryesisht në raportet e paraqitura nga Drejtoria për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

Në vendimin nr. 125 datë 26.03.2019, KPK evidenton të dhënat e vëna në dispozicion nga DSIK, se subjekti i rivlerësimit me detyrën prokuror, gjatë kryerjes së hetimeve në dy raste ka favorizuar shtetas të proceduar penalisht, kundrejt një shume të caktuar parash.⁹⁵ Konstatimi i papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, është verifikuar nga KPK që ka gjetur të bazuar konkluzionin e DSIK, duke argumentuar se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit cënon drejtpërdrejtë pastërtinë e figurës së tij dhe për pasojë, subjekti ka cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë, për një subjekt tjetër, shumica e trupit gjykues të KPK konkludon, se është në kushtet e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar, për shkak të mundësisë për vënien e tij nën presion nga strukturat kriminale, për favorizim apo për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, në papajtueshmëri të plotë me detyrën.⁹⁶

Për subjektin A. Z me funksion gjyqtar në Gjykatën e Lartë, raporti i DSIK është hartuar dhe ka konkluduar që subjekti është i papërshtatshëm bazuar në faktin se atij i është revokuar viza nga SHBA⁹⁷. Subjekti, në deklaratën e kontrollit të pastërtisë së figurës, i është përgjigjur “jo” pyetjes nëse gjatë 10 viteve të fundit, i ishte refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s. Për saktësinë e deklaratës, si dhe paraqitjen e vërtetë të fakteve sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016 prezumohet se ankuesi ka qenë i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit sipas ligjit Nr. 84/2016.⁹⁸ Gjyqtari i mbetur në pakicë për këtë çështje, arsyeton se, instituti i refuzimit të hyrjes në një shtet nuk është i njëjtë me atë të refuzimit/revokimit të vizës, por lidhet me pengesën objektive që një subjekt ka pasur për të hyrë në territorin e një shteti.⁹⁹ Në rastin konkret, në vlerësimin e këtij anëtari mungon shkaku kushtetues për shkarkim dhe se pasaktësitë e konstatuara në formularin e kontrollit të figurës duhet të jenë rezultat i përpjekjes së subjektit të rivlerësimit për të fshehur të dhëna apo për t'i paraqitur gabimisht ato në funksion të manipulimit të organeve që do të kryejnë kontrollin e figurës dhe arritjes prej tyre në konkluzione pozitive për subjektin e rivlerësimit, pa ditur të gjithë të vërtetat e tij në raport me figurën e lidhjet e tij me kontakte të papërshtatshme.¹⁰⁰

⁹⁵ KPK, Vendimi Nr. 125 datë 26.03.2019, faqe 5

⁹⁶ Vendimi Nr. 136 datë 19.04.2019, faqe 24

⁹⁷ KPA, vendimi nr.2 datë 04.02.2019. Kolegji argumenton më tej se : “Komisioni argumenton se gjithsesi, po të bëjmë diferencën ndërmjet revokimit të vizës dhe refuzimit të hyrjes, e para ka të bëjë me anulimin e një vize ekzistuese, siç e kemi konkretisht në rastin e subjektit të rivlerësimit. Sa i përket refuzimit të hyrjes, realizohet në dy mënyra, nëpërmjet refuzimit të dhënies së vizës në ambasadë, si dhe refuzimit të lejimit të hyrjes në kufi të një shteti të caktuar”.

⁹⁸ KPA, Vendimi Nr. 02 datë 04.02.2019, faqe 37

⁹⁹ Shih vendimin fq 36

¹⁰⁰ KPA, Vendimi Nr.02. date 04.02.2019, mendimi i gjyqtarit të pakicës

Përsa i takon praktikës së ndjekur lidhur me kërkesat e subjekteve për tu njohur me raportet e hartuara nga DSIK, për subjektin F.P, KPK bazuar në kërkesën e subjektit për tu njohur me këtë raport, ka kërkuar deklasifikimin e raportit fillestar të DSIK-së dhe pas deklasifikimit, ia ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit.¹⁰¹

8. Vendimmarrja e KPK-së për ndërprerjen/pushimin e vettingut

Për periudhën Janar - Dhjetor 2019 vendimmarrja e KPK-së për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit ka ndodhur për arsye të mbushjes së moshës për të dalë në pension ose dorëheqjes.

Në rastin e subjektit M.Xh, KPK ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit me arsyetimin e mos pasjes së statutit të magjistratit nga subjekti.¹⁰² Në vendimin e tij, KPK argumenton se ligji nr. 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, parashikon një maksimum prej 3 vjetësh për gjyqtarët që shërbejnë në strukturat jashtë gjyqësorit, periudhë pas së cilës ata duhet të kthehen në pozicionet e tyre të mëparshme, ndërsa ligji i mëparshëm për organizimin e pushtetit gjyqësor (nr. 8436/1998), nuk kishte një parashikim të tillë. Ky vendim krijon një debat juridik lidhur me interpretimin e akteve ligjore që normojnë statusin e magjistratit me dispozitat e ligjit për vettingun. Mendimi i gjyqtarit në pakicë në këtë vendimmarrje argumenton se afati 3-vjeçar që ligji i vitit 2008 zbatohet vetëm ndaj gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat jashtë gjyqësorit, pas hyrjes në fuqi të tij dhe nuk mund të kishte fuqi prapavepruese ndaj gjyqtarëve të rekrutuar në strukturat jashtë gjyqësorit.¹⁰³ Sipas gjyqtarit në pakicë, subjekti i rivlerësimit, ka marrë një pozicion “*sui generis*”, funksionet e saj si gjyqtare “ngrijnë”, por kurrësesi nuk mund të pranohet largimi nga këto funksione.¹⁰⁴

Në një prej vendimeve të studiuara, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit, pas zhvillimit të seancës dëgjimore në KPK. Trupi gjykues në këtë rast ka vendosur shkarkimin e subjektit me arsyetimin se kërkesa e dorëheqjes duhet të paraqitet përpara Këshillit përkatës dhe se trupi gjykues, sipas nenit 55, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.¹⁰⁵

¹⁰¹ Vendimi Nr. 136 datë 09.04.2019

¹⁰² Neni 42 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 2 dhe 4 përcakton se vlerësimi i inspektorëve që nuk janë magjistratë, do të bazohet në: (i) dokumentet ligjore; dhe (ii) rezultatet e testimi nga Shkolla e Magjistraturës. Dispozitat ligjore të ligjit nr. 96/2016, neni 165 parashikon se, inspektorët që nuk kanë statusin e magjistratit do t'i nënshtrohen testimi nga Shkolla e Magjistraturës si pjesë e procesit të rivlerësimit të tyre. Neni 168 parashikon se, Kryeinspektori dhe inspektorët e tjerë që gëzojnë statusin e magjistratit, do të konsiderohen si magjistratë dhe do të vlerësohen sipas ligjit për rivlerësimin kalimtar

¹⁰³ Vendimi nr. 115, datë 11.03.2019, fq 10

¹⁰⁴ Shih Vendimin e KPK-së nr. 115 datë 11.03.2019, fq 11

¹⁰⁵ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 97 datë 10.07.2019.

9. Struktura e vendimeve të institucioneve të vettingut

Nga monitorimi i vendimeve të arsyetuara, rezulton se vendimet e KPK-së dhe KPA-së, si në rastin e konfirmimit në detyrë dhe në atë të shkarkimit, janë tepër voluminoze. Vendimet e KPK-së pasqyrojnë në mënyrë të detajuar rezultatet e hetimit administrativ bazuar në një, dy, ose tre kriteret e vlerësimit, ndërkohë që KPA në vendimmarrjen e saj analizon shkaqet ligjore dhe kushtetuese të ankimit si dhe bazueshmërinë e rezultateve të hetimit të realizuar nga KPK konform akteve ligjore.

Në pjesën më të madhe të rasteve vendimet e studiuara janë të organizuara sipas kërkesave të nenit 57 të ligjit nr.84/2016. Megjithatë, vlen të evidentohet, se vendimet e KPA-së paraqesin një standart më të mirë dhe më të konsoliduar sa i takon; strukturës së vendimit, përmbledhjes së fakteve, evidentimit në mënyrë të strukturuar për secilin kriter të shkaqeve të ankimit, pretendimeve të subjektit dhe Komisionerit, provave të siguruara prej tyre, provave të siguruara nga hetimi administrativ nëse ky është kryer nga KPA, si dhe dhënies së vlerësimit nga vetë trupa e KPA-së për secilin shkak ankimor dhe pretendim të palëve. Gjithashtu edhe cilësia e arsyetimit në vendimet e KPA-së është në një standart më të avancuar në raport me arsyetimin e bërë nga trupat gjykuese të KPK-së.

Një rol të veçantë gjatë arsyetimit të vendimit i është kushtuar pretendimeve të subjekteve të rivlerësimit. Përsa i takon rolit të ONM, vërehet se KPK i reflekton rastet kur ka ndërhyrje të përfaqësuesve të ONM, kryesisht për rastet e verifikimit të kontrollit të figurës.¹⁰⁶ Opinioni dhe gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar adresoheshin në denoncimet e publikut të cilat nuk plotësonin kërkesat e nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, pasi ato nuk sigurojnë një bazë të nevojshme për të vlerësuar shkeljen ligjore dhe nuk krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore.¹⁰⁷ Gjithashtu për rastin e subjektit D.P, vëzhguesi ONM ka paraqitur opinion dhe gjetje për një denoncim të depozituar pranë ONM, i cili i ka shërbyer Komisionit në vlerësimin përfundimtar të subjektit për konfirmim në detyrë, dhe transferimin pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore¹⁰⁸.

Në rastet kur anëtari ka pasur një mendim kundër, apo mendim paralel, ai gjendet i arsyetuar dhe i është bashkëngjitur vendimit përfundimtar. Vendimmarrja përsa i takon Kolegjit paraqet më shumë raste kur anëtarë të tij kanë shfaqur mendime paralele, ose kundër shumicës. Rastet kur anëtari ka shfaqur mendim paralel lidhen me qëndrime të ndryshme në raport me arsyetimin e trupës gjykuese, për disa nga shkaqet e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit; por që nuk afektin qëndrimin pro vendimmarrjes së trupës për lënien në fuqi të vendimit për shkarkimin e subjektit.¹⁰⁹

¹⁰⁶ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 117 datë 21.03.2019

¹⁰⁷ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 117 datë 21.03.2019, faqe 20

¹⁰⁸ Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Vendimi Nr. 112, datë 04.03.2019.

¹⁰⁹ Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Vendimi nr. 02 datë 04.02.2019

Më disa raste të shqyrtimit të çështjeve në Kolegj, në rastet kur ankimi është depozituar nga ana Komisionerit Publik, shkaqet dhe argumentat e paraqitura nga ky i fundit kanë shërbyer si argument nga ana e Kolegjit për vendimmarrjen përfundimtare, (vlen të përmenden vendimet për subjektin B. M, A. M, N.K, G. M¹¹⁰). Pavarësisht rolit që ka luajtur institucioni i Komisionerit Publik në konsolidimin e praktikës së Kolegjit dhe Komisionit si dhe në interpretimin që i janë bërë disa prej instituteve përbërëse pjesë të procesit të rivlerësimit, Kolegji mund të elaboronte shkaqet e ankimit me argumenta të veta duke ruajtur balancën midis shkaqeve të ankimit të paraqitura nga ana e Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit.

¹¹⁰ Vendim Nr. 27/2019 (JR) datë 24.10.2019, Vendim Nr. 21/2019 (JR) datë 13.09.2019, Vendim Nr. 18/2019 (JR) datë 26.07.2019, Vendim Nr. 32/2019 (JR) datë 21.11.2019.

Rekomandime

Rekomandimi 1: I sugjerojmë institucioneve të vettingut të sigurojnë transparencë të plotë në seancat dëgjimore dhe vendimmarrjet e tyre, për disa nga aspektet e procesit të analizuar në këtë raport (si metodologjia e vlerësimit të kriterit pasuror, denoncimet e publikut, rezultatet e hetimit administrativ për të trija kriteret, rekomandimet e vëzhguesve të ONM-së, etj). Vëzhgimi dhe aksesimi i publikut dhe i medias në seancat dëgjimore duhet të vijojë konform standardeve pozitive të vendosura në praktikën e deritanishme të institucioneve të vettingut.

Rekomandimi 2: Sugjerojmë që institucionet e vettingut të realizojnë një komunikim pro-aktiv me qytetarët dhe ti informojnë ato mbi ecurinë e shqyrtimit të denoncimeve të tyre. Gjithashtu, kemi mendimin se ankesat e qytetarëve të lidhura me themelin e çështjeve të hetuara dhe të gjykuara kërkojnë një hetim më të thelluar dhe gjithëpërfshirës për të evidentuar, shkelje ose jo të indikatorëve dhe nënindikatorëve të kriterit të aftësive profesionale në mënyrë të veçantë.

Rekomandimi 3: I sugjerojmë organeve të vettingut të publikojnë në faqet e internetit të dhëna statistikore periodike dhe të përditësuara, për numrin e subjekteve dhe rezultatet e procesit në mënyrë periodike.

Rekomandimi 4: I sugjerojmë trupave gjyqese të KPK-së që në përfundim të hetimit administrativ, të vendosin në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit një afat sa më të arsyeshëm dhe të orientuar drejt standartizimit (unifikimit) për të paraqitur prova shtesë, komente, shpjegime dhe mendime rreth tyre (si p.sh. minimalisht 10 ditë).

Rekomandimi 5: Për një akses sa më të lehtë në gjetjen dhe leximin e vendimeve të KPK, do të sugjerim një organizim më të mirë të rubrikës së publikimit të listës së vendimeve, në mënyrë që të mundësojë përdorim sa më praktik të saj nga të gjithë të interesuarit, duke vendosur në këtë rubrikë numrin rendor të vendimit, datën e publikimit të vendimit të arsyetuar në këtë faqe, identitetin e subjektit, si dhe funksionin.

